



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 296/4 prot.

Tiranë, më 14._09.2023

V E N D I M
Nr. 183, Datë 14.09.2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr.29 Regj, datë 21.02.2023, paraqitur nga ankuesi Z.R.G, kundër Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë³, me pretendimin për diskriminim për shkak të “vendbanimit”, “prejardhjes krahinore”, “arsye kulturore” dhe “vendlindjes”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi Z.R.G parashtron se, ka qenë njëri prej kandidatëve që ka aplikuar për vendin e lirë të hapur në muajin prill 2022 në Akademinë e Shkencave për fushën “Histori”.

Më datë 19.12.2022, ankuesi shpjegon se ka paraqitur punën e tij shkencore para Seksionit të Shkencave Humane dhe Ekonomike, një trupë akademike e përbërë prej së paku 21 anëtarësh, nga të cilët të pranishëm ishin vetëm 8-9 prej tyre, më pak se gjysma e anëtarëve të caktuar nga ligji (Neni 26 i Statutit, Procesverbali i datës 19.12.2022 për prezantimin dhe votimin në seksionin përkatës). Në votimin e realizuar pas prezantimit, ku janë marrë parasysh edhe votat e sjella paraprakisht në mënyrë të paqartë, ankuesi ka marrë 9 vota kundrejt 8 vota të konkurentit tjetër. Kjo votë superiore më pas, sipas rregullave akademike (Neni7, pika 8 e Statutit), do të duhej të kushtëzonte sipas ankuesit, rankimin që u paraqitet anëtarëve të Asamblesë në votimin final në fletën e votimit (rreshtimi i kandidatëve në fletën e votimit, me marrëveshje asambleare (Statuti, Neni 7, pika 8), u jep mundësi anëtarëve të Asamblesë së Akademisë së Shkencave të kuptojnë rankimin që ka caktuar Komisioni i Specializuar në Shkencat Humane. Mbledhja dhe votimi

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Akademia e Shkencave ose ASH.

përfundimtar u krye me datë 6.02.2023, pas tre shtyrjeve të pashpjegushme në kundërshtim me nenin 28 të statutit (data e votimit përfundimtar ishte vendosur fillimisht me 29.12.2022, më pas u caktua data 30.01.2023 dhe pasi u anulua dy herë në rrethana të paqarta dhe pa asnjë shpjegim nga ana e tyre për kandidatët, procesi u zhvillua ditën e hënë më 06.02.2023). Procesi është mbyllur pa asnjë fitues për anëtarin e ri të fushës së historisë.

Të nesërmen, më datë 07.02.2023, ankuesi informon se i ka kërkuar Kryetarit të Akademisë së Shkencave vendosjen në dispozicion të çdo dokumenti që lidhet me procesin në tërësi, përfshirë fletët e votimit dhe dokumentimin video të procesit etj. Njëkohësisht i ka kërkuar institucionit shpjegime në lidhje me procedurën, transparencën dhe arsyen pse ishin shkelur të drejtat e tij, në lidhje me informimin dhe prezantimin e bërë para anëtarëve të Asamblesë. Ankuesi shprehet se, vetëm pas ndërhyrjes së Ministres së Arsimit dhe Sportit, me datë 09.02.2023, pas 72 orë pengim, administrata e Akademisë së Shkencave i ka vendosur në dispozicion një pjesë të vogël të materialit, përmes një komisioni të përbërë nga akademikë, që nuk janë punonjës të brendshëm të Akademisë së Shkencave. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, ankuesi parashtroi se ka konstatuar sa më poshtë vijon:

- 1- Akademia e Shkencave nuk ka dorëzuar sipas kërkesës së tij, procesverbalin dhe relacionin e procedurës së zhvilluar më datë 19.12.2022, në Seksionin e Shkencave Sociale, Humane dhe Ekonomike.
- 2- Ndryshe nga çfarë përmban rregullorja, statuti, rregullorja e zgjedhjeve të reja, administrata e ASH kishte vendosur një rankim të përmbysur në Fletën e Votimit të paraqitur para akademikëve, vetëm për kandidatët e historisë. Duhej që fituesi i datës 19.12.2022, të vendosej i pari. Ka ndodhur e kundërta, duke i ofruar kështu anëtarëve të Akademisë që ishin votues një imazh dhe kujtesë të përmbysur të rezultateve të vlerësimit të komisionit të Shkencave Humane. (Statuti, neni 7, pika 8)
- 3- Zotërinjtë e Komisionit Zgjedhor që erdhën në ballafaqim, fillimisht bënë të paditurin mbi gjithë procesin e mëparshëm, atë të fletëve të votimit të dorëzuara disa ditë para votimit dhe e konsidruan vetën si numërues të thjeshtë, penguan dhënien e plotë të fotokopjeve të materialeve zgjedhore dhe të zarfave me të cilët kishin mbërritur votat, por që nuk korrespondojnë në numra mes gjendjes faktike dhe numrave të shënuar në procesverbal. Pyetja është: a kanë ndodhur hedhje vote të deleguar ditën e votimit dhe a lejohet që anëtarët e një familje të jenë pjesë e Akademisë?
- 4- Për të shmangur subjektivitetin vlerësues, ASH duhej të kishte përgatitur më përpara Instrumentin e Vlerësimit të Punës së Kandidatëve. Nga përgjigja, një dokument i tillë individual për secilin kandidat, jo vetëm që nuk ishte përgatitur, por nuk ishte e qartë si një instrument i tillë duhet të ekzistonte. Më së shumti, procesi zgjedhor është i bazuar në një prapaskenë të komanduar nga syri dhe mendja e Kryetarit të Akademisë, i cili komandon të gjithë procesin me orientim. Akademia e Shkencave nuk ka një rregullore që duhet të zbatohet për vlerësimin e punës dhe veprimtarisë shkencore të kandidatëve konkures.
- 5- Akademia e Shkencave nuk ka një rregullore të marrjes në dorëzim dhe numërimit të fletëve të votimit, për kandidatët që nuk e kanë të mundur të paraqiten në mbledhjen e Asamblesë,

anëtarëve që nuk paraqiten në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për arsye pune etj, nuk parashikohet as mënyra se si do të dërgohen fletët e votimit tek anëtarët e pamundur, tek ato që banojnë jashtë vendit dhe mënyra e hapjes dhe e ruajtjes së sigurt e secilës kategori, në mënyrë të kontrolluar dhe me elementët e sigurisë dhe drejtësisë, për t'iu dorëzuar komisionit të numërimit në mënyrë transparente. Nga ballafaqimi u dëshmuua si pa gjë të keqe se, 14 ose 16 fletë votimi janë ruajtur në paradhomenë e Kryetarit të ASH, në një dosje të hapur dhe lehtësisht të prekshme, për shkak të mungesës së vulave të dyllosura dhe ruajtjes në kasaforta që hapen vetëm nga anëtarët e ngarkuar të komisionit.

- 6- Nga verifikimi i fletëve të votimit, u konstatua se procesverbali i mbajtur njoftonte se ekzistonin 14 zarfe votimi për kandidatët që kanë marrë pjesë në këtë procedurë nga shtëpitë e tyre. Ndërkohë, në dokumentet zgjedhore gjendeshin vetëm 10 zarfe. Ku janë 4 zarfe dhe 4 fletët e tyre të votimit që duhet të kishin datën 30.01.2023, sikurse 10 fletët zgjedhore të të tjerëve. Komisionarët nuk shpjeguan dot pse ishin prodhuar aq shumë fletë votimi për datat 30.01.2023 dhe 06.02.2023 dhe si kontrollohej ky moment. Nëse nuk ishin përdorur, si ishin asgjesuar dhe hequr në protokoll nga qarkullimi.
- 7- ASH nuk ka të parashikuar asgjë mbi mënyrën e prodhimit, dokumentimit, shënimit të elementëve të sigurisë dhe marrjes në ruajtje të fletëve të votimit. Edhe në votimin e fundit nuk dihet ku janë prodhuar dhe ruajtur këto fletë votimi, as shtypshkronja dhe as numri i tyre. Nuk ekziston një kopje e procesverbalit të prodhimit të fletëve të votimit dhe elementët e sigurisë të përcaktuara paraprakisht nga Kryesia e ASH. Pas ballafaqimit të datës 9.02.2023 nga dëshmitë e dy komisioneve që u paraqitën, rezultoi se fletët e votimit ishin printuar si çdo letër e zakonshme në paradhomenë e kryetarit të ASH. Ky është një veprim tërësisht i papranueshëm pasi është jashtë normave të sigurisë dhe garnacisë.
- 8- Akademia nuk ka të paraqitur publikisht në faqen e saj kopjen e listës së anëtarëve të Akademisë që kanë votuar paraprakisht dhe atyre që kanë marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë, nuk ka të ekspozuar as listën e fletëve të votimit të deleguar të nisur për datat 19.12.2022 dhe 06.02.2023.
- 9- Nuk ekziston asnjë procesverbal dhe asnjë dëshmi se anëtarët e Komisionit Zgjedhor të kenë shkuar në mënyrë të protokolluar për të marrë votën e anëtarëve të pamundur nëpër shtëpitë e tyre, sipas rregullave në çdo votim serioz, as për datën 19.12.2022 dhe as për atë të datës 06.02.2023. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për anëtarët që kanë ardhur paraprakisht për të votuar në sekretarinë e ASH. Nuk dihet ku e kanë hedhur votën dhe si është ruajtur vota e tyre. Cila është garancia që vota e tyre nuk mund të tjetërsohet për asnjë lloj arsye në kabinetin qeverisës të ASH? Në fakt, nuk ekziston një proces-verbal i Komisionit Zgjedhor të anëtarëve të ASH që kanë votuar në sekretarinë e ASH, në dy proceset, atë të datës 19.12.2022 dhe atë të datës 06.02.2023, procedurën e garancisë së votës së tyre për të dy raundet, procesverbalin e marrjes dhe hapjes së fletëve të votimit të deleguara.
- 10- Edhe pse nuk ka një rregullore të brendshme të ASH që ndalon kandidatët të prezantojnë punën e tyre para anëtarëve të Asamblesë së ASH, kandidatët nuk janë lejuar të kryejnë një veprimtari të tillë më datë 06.02.2023 në Asamblenë e ASH. Madje, çuditërisht prezantimin e veprimtarisë së kandidatëve e ka bërë Kryetari i ASH, person aspak kompetent për të folur për veprimtarinë, le të themi në fushën e historisë. Ai ka përmendur një numër të dhënash të

parëndësishme dytësore, por shumë pak mbi punën e mirëfilltë shkencore dhe kjo është e papranueshme.

- 11- Edhe pse nuk ka asnjë pikë që ndalon kandidatë ose përfaqësuesit ligjorë të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së ASH, disa kandidatë (R.G, për shembull) nuk janë thirrur të jenë prezent ndërkohë që disa të tjerë (A.H, për shembull) janë thirrur, kanë marrë pjesë në mbledhje në pjesën e parë dhe kanë qenë të pranishëm në mjediset e institucionit në të gjithë pjesën e dytë, atë të votimit. Mjafton të hapni faqen zyrtare të facebook-ut të Akademisë për ta provuar një gjë të tillë. Ky përbën një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues.
- 12- Procesverbali i mbylljes së numërimit është i parregullt dhe i pafirmosur në fletën 1 dhe 2, të cilëve u është bashkangjitur fleta 3 e firmosur nga 3 anëtarë, kur janë protokolluar pas këmbënguljes sime, mendoj, në 72 orët që patën në dispozicion administratorët akademikë, për të rregulluar letrat në vonesën e përgjigjes ndaj meje. Numri i protokollit ndryshe çfarë operon Akademia në rastet e mëparshme, është shënuar me shkrim dore 84/1, me datë 06.02.2023. Ankuesi deklaroi se, i janë dhënë gabimisht me datë 09.02.2023 gjatë ballafaqimit, dy kopje të tilla dhe ato përmbajnë firma të vendosura në kohë të ndryshme, jo të njëjta. Duket qartë se ato dokumente janë përgatitur jo në vend, për t'iu ekspozuar anëtarëve para mbylljes së mbledhjes, por pas saj. Këtë ma përforcon gabimi që është bërë në numërimin e votave të mia të raundit të parë, shënuar 11 në proces-verbal, ndërkohë që në fakt kanë qenë 12, lehtësisht e verifikueshme kjo nga kamerat e sigurisë që kanë regjistruar mbledhjen e Asamblesë deri në fund.
- 13- Në dosjen e procesit zgjedhor të datës 06.02.2023, nuk ekziston një procesverbal që anëtarët e Komisionit Zgjedhor të kenë shkruar në mënyrë të protokolluar për të marrë votën e anëtarëve të pamundur, sipas rregullave në çdo votim serioz, as në datën 19.12.2023 dhe as për atë të 06.02.2023.

Gjatë përvojës disa mujore të konkurimit, ankuesi shprehet se është përballur në mënyrë të hapur dhe të fshehtë me një lloj armiqësie dhe paragjykimin kulturor, të paimagjinueshëm dhe mbi të gjitha për një vend që teorikisht do të ishte i drejtuar nga qenie atdhetare. Sipas tij, një sjellje e tillë është e lidhur me gjithë punën e tij për rishkrimin e Historisë së Shqipërisë, posaçërisht për periudhën e viteve 1939-1946 dhe qënien e tij si deputet i zgjedhur nga një qytet opozitar siç është Shkodra. Kjo pavarësisht se qëndrimet e tij në Parlament, fjalimet e mbajtura, kanë qenë krejt teknike dhe kanë qenë të lidhura me reformat tërësore dhe zhvillimin rajonal.

Z. G deklaroi se, askush nuk do të imagjinonte para tre dekadash, që në qendër të Tiranës, në piramidën qeverisëse të shkencës, që dikur është drejtuar nga Koliqi, Harapi, Buda, Çabej, Popa, dhe ku xhaxhai i tij Prof.K.G, ka qenë anëtar themelues (Komisia Letrare Shkodër, Instituti i Studimeve Shqiptare, Tiranë, pararendës i ASH), do të krijohej një institucion i drejtuar me paragjykim, me sfond politik, kulturor dhe krahinor. Të jesh nga Shkodra dhe Gegnia shqiptare, përbën një disfavor të jashtëzakonshëm, për shkak të preferencave të Kryetarit (mjafton një vlerësim statistikor në përgjithësi dhe i zgjedhjeve të fundit, bazuar në certifikatën familjare të vendlindjes për ta vërtetuar këtë). Mirëpo, për fat të keq, atë e kemi sot një realitet veprues në qendër të Tiranës, në institucionin më të lartë të shkencës, në funksion të përjetësimit të rolit të

individit të të kaluarës jo të lavdishme dhe “entourage” rreth tij, në Akademinë e Shkencave është krijuar një sistem i pilotuar dhe i paracaktuar anëtarësimesh, që ka çuar në një përmbysje irracionale të hierarkisë profesionale dhe intelektuale, në një çrregullim të parimeve morale të përzgjedhjes së drejtuese dhe në një “autonomi” sjelljesh të pakontrolluara, nën etiketën e institucionit të pavarur.

Ankuesi pretendon se, veprimtaria e kryer nga institucioni i lartpërmendur si proces tërësor në aspektin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj është zhvilluar në shkelje të të drejtave qytetare, kuadrit ligjor për zgjedhje të lira, bazuar mbi kritere dhe instrumente vlerësimi akademik, nisur nga kritere të kamufluara të një paragjykimi politik dhe kulturor. Sipas ankuesit, është e papranueshme që rezultatet e kërkimit dhe tezat e hedhura nga ana e tij në veprat kryesore, të jenë objekt shqyrtimi në Komisionin e Historisë, nga persona jokompetentë dhe me gradë më të ulët se sa titujt e tij akademikë. Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri:

- Konstatimin e diskriminimit;
- Hartimin e rregullave dhe procedurave të sakta dhe të qarta të procesit të konkurimit, vlerësimit paraprak, përmes instrumentit përkatës dhe votimit bazuar në performancën e kandidatëve në planin shkencor;
- Vendosi para përgjegjësisë ligjore të drejtuesve, që nuk mund të vazhdojnë më të drejtojnë një institucion derisa kanë thyer ligjet, kanë krijuar strukturat departamentale, pa asnjë lidhje me legjislacionin shtetëror mbi formimin e organeve akademike dhe kanë kryer procedura të pasigurta nga pikëpamja e respektimit të paanësisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: **“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”**

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminim garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një

trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.296/1 prot, datë 13.03.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Akademia e Shkencave, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Me shkresën nr.220/1 prot., datë 24.03.2023⁴, Akademia e Shkencave ka kthyer përgjigje në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë, duke parashtruar ndër të tjera se:

Në pretendimet për diskriminim të paraqitura nga ankuesi në lidhje me procesin e konkurimit e zgjedhjes së anëtarëve të rinj, nuk jepet asnjë fakt konkret se në cilin akt e dokument a veprim të Akademisë së Shkencave dhe strukturave të saj konstatohet një gjë e tillë nga ankuesi.

ASH sqaron se, rregullorja e brendshme administrative është hartuar për veprimtarinë e administratës ndihmëse të Akademisë. Në nenin 2, specifikohet *ad litteram* se kjo rregullore ka si objekt të saj përcaktimin e përgjegjësive, detyrave dhe marrëdhënieve të punonjësve të administratës si dhe nëpunësve të strukturave të ASH në kryerjen e veprimtarive administrative si dhe përcaktimin e rregullave për rekrutimin, punësimin, disiplinën në punë, masat disiplinore dhe procedurat përkatëse të punonjësve të administratës e nëpunësve të çdo niveli, përveç atyre të rregulluar me Statutin e ASH.

ASH sqaron se, vlerësimin i kandidatëve që kandidojnë për anëtarë të Asamblesë së Akademisë së Shkencave bëhet referuar Statutit të Akademisë së Shkencave.

Lidhur me kërkesën për informacion të Komisionerit në lidhje me vendlindjen e anëtarëve të Asamblesë së Akademisë së Shkencave, përfshirë këtu dhe anëtarët e dalë nga zgjedhjet e fundit të zhvilluara në datën 06.02.2023, ASH parashtron se, referuar ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, në nenin 7 të tij, ka parashikim specifik për kufizimet juridike lidhur me përpunimin e të dhënave. Nëse pavarësisht kufizimeve të sipërcituara, statusi jua lejon, ASH informon se, në faqen e saj zyrtare mund të gjenden jetëshkrimet e anëtarëve të Akademisë paraqitur prej atyre vetë, secili individualisht (përfshirë dhe ato të anëtarëve të Kryesisë e të kryetarëve të Sesioneve). Për lehtësi marrjeje të informacionit, në kushtet e këtij kufizimi juridik për përpunim të dhënash nga ana e tyre, për aq kohë sa anëtarësia e Asamblesë, duke lejuar publikimin në faqen zyrtare të saj, në respekt të ligjit, nuk i është kërkuar dhe as ka dhënë pëlqim statistikimi, gjithçka që mund të bëjnë është adresimi për marrjen e informacionit në linkun ku gjenden jetëshkrimet e anëtarëve të Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike – SSSHHA (<http://akad.gov.al/ash/home/seksionet->

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.296/2 prot., datë 28.03.2023.

ash/sshsha/anetar-sshsha) dhe të anëtarëve të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe teknike – SSHNT:(<http://akad.gov.al/ash/home/seksionet-ash/sshnt/anetar-sshnt>.)

Përfundimisht, ASH thekson se, ankesa për diskriminim e njërit prej kandidatëve të regjistruar në konkurim për titullin *akademik*, specifikisht në fushën *histori* , nuk mbështetet nga faktet.

2. Me *e-mailin*, e datës 29.03.2023, ankuesi ka dërguar prapësimet e tij në lidhje me parashtrimet e ASH, ku ndër të tjera deklaroi:

Shkresa e ASH nuk jep përgjigje për asnjë prej kërkesave të bëra nga ana e ankuesit dhe që kanë çuar në një diskriminim të mirëfilltë, sipas tij, nisur nga konteksti kulturor, rezultateve të punës kërkimore lidhur me Historinë Bashkëkohore të Shqipërisë, që janë publike dhe të ndryshme me linjat që mbrojnë ndonjë anëtarë i Akademisë dhe drejtuesi i Komisionit të Rishkrimit të Historisë aty. Ndërkohë nga dokumentacioni i paraqitur vërehen edhe elementë të tjerë të shkeljeve të ligjit dhe statutit.

Proces-verbali dhe relacioni i procedurës së zhvilluar me datën 19 dhjetor 2022 në Seksionin e Shkencave Sociale, Humane dhe Ekonomike, që këtë radhë është depozituar, përmban një paraqitje të falsifikuar të të vërtetës. Gjatë paraqitjes sime kanë qenë të pranishëm profesorët G.H, E.L, Gj.Sh, Sh.S, M.V, S.Ç, P.Xh, V. T dhe K.J, domethënë vetëm 9 anëtarë nga 21 anëtarë, pra më pak se gjysma. Është larguar pa filluar prezantimi, F.D dhe ka ardhur kur mbylla prezantimin M.K. Mungonte edhe zoti B.M. Vendosija e emrave të tyre në proces verbal është e pasaktë. Ata nuk kanë qenë të pranishëm në prezantimin e ankuesit dhe paskan votuar. E papranueshme. Pas numërimit të votave, mbledhja e të dhënave nuk korrespondon me numrin 21 të pjesëmarrësve për asnjërin prej kandidatëve. Shkresa nr.220, datë 24.03.2023, nuk sqaron asgjë në lidhje me këtë.

Përgjigja e datës 24.03. 2023 nuk sqaron pse, ndryshe nga çfarë e përmban rregullorja, Statuti, Rregullorja e Zgjedhjeve të Reja, administrata e ASH kishte vendosur një rankim të përmbysur në Fletën e Votimit, të paraqitur para akademikëve, vetëm për kandidatët e historisë. Duhej që fituesi i datës 19.12.2022 të vendosej i pari. Ka ndodhur e kundërta, në vend që të ankuesi të rankohej në vendin e parë është vendosur në të dytin, duke i ofruar kështu, anëtarëve të Akademisë që ishin votues, një imazh dhe kujtesë të përmbysur të rezultateve të vlerësimit të Komisionit të Shkencave Humane. (Statuti, Neni 7, Pika 8). Edhe në CV e paraqitur arbitrarisht nga Kryetari i Akademisë, nuk pasqyrohet fare rezultati i procedurës së datës 19.12. 2022.

E njëjta përgjigje e datës 24.03.2023, nuk shpjegon mënyrën se si është kryer procesi i votimit për akademikët që nuk kanë qenë të pranishëm as me datën 19.12.2022, as me datën 6.02.2023.

Përgjigja e datës 24.03.2023, nuk sqaron pse ASH nuk ka një Instrument të Vlerësimit të Punës së Kandidatëve, që është një matricë bazë që parandalon subjektivitetin dhe bën rankimin e kandidatëve para Asamblesë.

Akademia e Shkencave në përgjigjen e datës 24.03.2023, nuk tregon pse marrja në dorëzim dhe numërimi i fletëve të votimit, për kandidatet që nuk e kanë të mundur të paraqiten në mbledhjen e Asamblesë, anëtarëve që nuk paraqiten në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për arsye pune, nuk është bërë përmes një komisioni, me proces verbal; pse këto flete votimi nuk janë ruajtur në një vend të sigurtë, të vulosur nga anëtarët e komisionit?

Përgjigja e datës 24.03.2023 tregon qartë pse ASH nuk ka të parashikuar asgjë mbi mënyrën e prodhimit, dokumentimit, shënimit të elementëve të sigurisë dhe marrjes në ruajtje të fletëve të votimit. Edhe në votimin e fundit nuk dihet ku janë prodhuar dhe ruajtur këto fletë të votimit, as shtypshkronja dhe as numri i tyre. Nuk ekziston një kopje e Proces Verbalit të Prodhimit të Fletëve të Votimit dhe elementet e sigurisë së përcaktuar nga Kryesia e ASH paraprakisht.

Përgjigja e datës 24.03.2023, nuk tregon pse ankuesi është ndaluar të prezantoj punën e tij para anëtarëve të Asamblesë së ASH. Sipas ankuesit, Kryetari i ASH ka dhënë një ekspozitë të gabuar të shkollimit të tij, nuk ka dhënë asgjë mbi kualifikimin jashtë vendit, asgjë mbi veprat e tij që janë një rishkrim i plotë i historisë së shekullit XX dhe ka lënë qëllimisht mënjanë faktin që është profesor visitor në LSE. Ai ka përmendur një numër të dhënash të parëndësishme dytësore, por shumë pak mbi punën e mirëfilltë shkencore dhe kjo është e papranueshme. Kjo përbën një provë të mirëfilltë diskriminuese që duhet vlerësuar si një paraqitje e shtrembëruar dhe e qëllimshme e punës kërkimore dhe shkencore nga ana e drejtuesit të Akademisë.

Përgjigja e datës 24.03.2023 nuk tregon pse ankuesi, nuk është thirrur për të qenë prezent në mbledhjen e Asamblesë së Akademisë, ndërkohë që disa të tjerë (si A.H) janë thirrur, kanë marrë pjesë në mbledhje në pjesën e parë dhe kanë qenë të pranishëm në mjediset e institucionit në të gjithë pjesën e dytë, atë të votimit (A.H nuk është e vetmja, edhe dy kandidatë të tjerë kanë qenë prezent). Ky është një trajtim i pabarabartë dhe diskriminues.

Asnjë shpjegim nuk përmban përgjigja e datës 24.03.2023, pse proces-verbali i mbylljes së numërimit të datës 6.02.2023 është i parregullt dhe i pa firmosur në fletën 1 dhe 2, të cilave u është bashkangjitur fleta 3, e firmosur nga 3 anëtarë.

Shumatorja e shkeljeve të Statutit, ligjit shtetëror që garanton barazitë e të drejtave qytetare, të parregullsive procedurale, mungesa e garancive në sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve, zbrastëritje në vlerësimin akademik, mendjelehtësia e administrimit të të gjithë procesit të datave 19.12.2022 dhe 6.02.2023, dhe klima antidemokratike e krijuar ndaj akademikeve me rezultate dhe teza të ndryshme shkencore nga historiografia me prejardhje nga diktatura (të cilën përmes një komisioni rishkrimi të historisë të përzgjedhur pa asnjë konkurim publik e financon administrata e zotit Gjinushi, përbën në fund të fundit, një hapësirë abuzimesh me lirinë dhe të drejtat e njeriut, mundësi ndërhyrjesh dhe pilotimesh. Para së gjithash, ruajtja e 16 fletëve të votimit në zyrën e Kryetarit të Akademisë së Shkencave, në një dosje të hapur dhe jo në një kasafortë të vulosur, për ditë të tëra, e bën procesin e papranueshëm dhe *nul*. Në veprimtarinë e administratës së ASH, siç mund të kuptohet, ka një numër veprimesh në kundërshtim me

parashikimet e Statutit dhe Ligjit dhe konkretisht: Statuti, Neni 7, Pika 8; shkeljet procedurale të marrjes së votës së deleguar; falsifikimit të numrit të pjesëmarrësve në procedurën e datës 19.12.2022; 9 të pranishëm nga 21, në proces verbal shenohet 12 në 21, gjë që është falsifikim i të vërtetës; zarfave të votimit final të datës 6.02.2023; nuk korrespondojnë me numrin e votuesve me delegim; CV e paraqitur nga Kryetari i ASH me mangësi të qarta në dhënien e të dhenave mbi shkollimin (mungojnë dy ciklet e kryera në UT MA dhe PhD), veprimtaria shkencore e gabuar nuk jepen monografite dhe tekstet univeristare⁵; si dhe mosveprime, lejim zbrazëtish vlerësuese që kulmojnë në mungesën e Instrumentit të Vlerësimit për kandidatët rivalë.

Sipas ankuesit, në proces-verbalin e Mbledhjes së Komisionit të Shkencave Historike, kualifikimet e dhëna për të nga së paku dy prej anëtarëve janë të mbarsura me paragjykime ideologjike dhe të pavërteta (duke e konsideruar një studiuës të ri), që nuk janë sipas tij të lejueshme në një institucion sikurse është ASH . Këto, sipas ankuesit janë prova të klimës që ata kanë krijuar.

Ankuesi shprehet se, ka bindjen e tij personale të ardhur për shkak të përvojës së përjetuar gjatë këtij konkurimi, konkurimit për veprën më të mirë të 75 vjetorit të çlirimit (2019), përjashtimit nga Komisioni për Rishkrimin e Historisë në këtë Akademi (një Komision i ndërtuar në kundërshtim me rregullat shtetërore të konkurimit publik në zënien e posteve publike), se në Akademinë e Shkencave të drejtuar nga zoti Skënder Gjinushi dhe vartësit të bindur të tij, është krijuar një sistem që përjashton këdo që kulturalisht nuk përkon me formësimet e ekipit drejtues dhe këdo që nuk garanton procesin e rizgjedhjes së kryetarit dhe vartësve të tij sërish në atë institucion (sivjet zhvillohen zgjedhjet e reja për Kryetarin e ASH). Besoj se prova mbi boten e brendshme, prapamendimet e faktorëve vendimarrës, askush nuk mund të sjellë, për të provuar diskriminimin me kontekst kulturor dhe krahinor. Shqyrtimi i parregullsive, shkelja e ligjeve, veprimet e parregullta dhe të mangëta që sjellin rezultate dekapituese për njerëzit e punës, akademikët kandidatë, në fund të fundit, nuk janë gjë tjetër veçse rruga nga ku ka ecur dhe ligjëruar një proces diskriminues prej anës së autoriteteve.

3. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: “ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, me shkresën nr. 296/3 prot., datë 08.05.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seancë dëgjimore publike.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 17.05.2023. Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesi i cili u paraqit personalisht, ndërsa u zhvillua në mungesë të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, pasi ASH nuk u paraqit në seancë dëgjimore, pavarësisht se ka marrë rregullisht dijeni për

⁵ Visiting Research fellow ne LSE shih: <https://www.lse.ac.uk/International-History/People/visiting-research-fellows/g.....>)

datën dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore, dhe nuk paraqiti asnjë shkak për mosparaqitjen e saj.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Faktet dhe rrethanat e çështjes.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, rezulton se ankuesi R.G, është i datëlindjes 18.09.1963, me vendlindje në Tiranë dhe banim në Shkodër. Ai është i punësuar si punonjës shkencor pranë Institutit të Historisë, Akademia e Studimeve Albanologjike.

Rezultoi se, me vendimin nr.25, datë 18.04.2022, Asambleja e Akademisë së Shkencave, vendosi hapjen e 4 (katër) fushave të reja për pranimet e anëtarëve të rinj të Asamblesë (akademikë) dhe fillimin e procedurave përkatëse. Fushat e reja për konkurim të hapura ishin: 1 (një) vend në shkencat arkeologjike për titullin akademik; 1 (një) vend në shkencën e historisë për titullin akademik; 1 (një) vend në shkencën e gjuhësisë për titullin akademik; dhe 1 (një) vend në shkencat e zooveterinarisë për titullin akademik. Sipas këtij vendimi, Kryesia e ASH, ngarkohej me detyrën që brenda datës 19 prill 2022 të shpallte kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit të kandidaturave, si dhe dokumentet e nevojshme për regjistrim.

Me shkresën nr.308/1 prot datë 19.04.2022 “Shpallja e vendeve të lira për anëtar të Asamblesë së Akademisë së Shkencave “Thirrje për pjesmarrje””, Kryesia e ASH i është drejtuar institucioneve të arsimit të lartë (IAL) publike dhe private, si dhe institucioneve dhe qendrave kërkimore shkencore. Në thirrjen për pjesmarrje është parashikuar edhe procedura e konkurimit si më poshtë:

1. Paraqitja e interesit për konkurim datë 19 prill deri më datë 19 qershor 2022.
2. Verifikim e shqyrtim i plotësimit të kriterëve ligjore nga Komisioni Teknik pranë ASH nga data 19 qershor deri më datë 19 korrik 2022;
3. Vlerësimi i motivuar nga njësia bazë universitare a kërkimore ku punon ose ka ushtruar aktivitetin kryesor kandidati, si dhe nga senati apo këshilli shkencor ku kandidati ka fituar titullin “profesor”. Vlerësimi bëhet përmes votës konsultative për mbështetjen ose jo të kandidaturës nga data 01-20 shtator 2022.
4. Shqyrtimi i kandidaturave në komisionet dhe seksionet shkencore të ASH në periudhën shtator-tetor 2022.
5. Votimi i kandidaturave në Asamblenë e ASH deri në fund të dhjetorit të vitit 2022.

Në thirrjen për pjesmarrje është pasqyruar edhe dokumentacioni që kërkohet për kandidim.

Në përfundim të afatit 2(dy) mujor (19 prill – 19 qershor) të paraqitjes së interesit për konkurim dhe referuar relacionit me nr. 452 prot, datë 21.06.2022 “*Mbi verifikimin e dokumentacionit për kandidatët që kandidojnë për vendet e lira për anëtarë të Asamblesë së Akademisë së Shkencave*”, të hartuar nga Komisioni Teknik i Verifikimit, që funksionon pranë ASH, rezulton se, gjithsej janë paraqitur 9 kandidatë. Rezulton se, ankuesi R.G, ka qenë njëri prej kandidatëve që kanë aplikuar për vendin e lirë të hapur nga Akademia e Shkencave në fushën e historisë. Në të njëjtën fushë me ankuesin rezulton të kenë aplikuar edhe 2 kandidatë të tjerë.

Pas procedurës së kryer në lidhje me verifikimin e figurës së kandidatëve të cilët kishin aplikuar, Komisioni Teknik i Vlerësimit, pranë ASH, me shkresën nr.452/1 prot., datë 17.10.2022 “*Mbi verifikimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për kandidatët që kandidojnë për vendet e lira për anëtarë të Asamblesë së Akademisë së Shkencave*”, i është drejtuar Kryesisë së ASH, duke e informuar për plotësimin e kriterëve teknike dhe ligjore nga kandidatët. Nga verifikimi ka rezultuar se, nga 9 (nëntë) kandidatura gjithsej, 3 (tre) kandidatë nuk mund të vazhdonin garën, pasi nuk plotësonin kushtin e mbajtjes së titullit shkencor “profesor” prej jo më pak se 8 (tetë) viteve nga hyrja në konkurim. Për shkencën e historisë për titullin akademik për 1 (një) vend, nga 3 (tre) kandidaturat e paraqitura, plotësonin kriteret 2 (dy) kandidatura, ku përfshihet ankuesi dhe kandidati H.K.

Me vendimin nr.62, datë 24.10.2022 “*Për vijim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për titullin akademik*”, Kryesia e ASH ka vendosur, të miratojë vijimin e procedurës së konkurimit për 6 (gjashtë) kandidatët që plotësojnë kriteret e parashikuara në ligjin dhe Statutin e ASH, konkretisht: në fushën e arkeologjisë 2 (dy) kandidatë, në fushën e historisë, ku ka aplikuar ankuesi, 2 (dy) kandidatë; në fushën e gjuhësisë 1 (një) kandidat; dhe në fushën e zooveterinarisë 1 (një) kandidat. Sipas këtij vendimi të Kryesisë së ASH, brenda datës 25.11.2022, Sekretari Shkencor i ASH duhet t’u drejtohej për vlerësim njëjësive bazë dhe senateve akademike ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre kandidatët. Komisionet dhe Seksionet përkatëse ngarkoheshin me detyrën për kryerjen e vlerësimit sipas nenit 7, pikat 8-9 të Statutit deri në fund të muajit nëntor 2022.

Nga aktet e administruara dhe konkretisht dokumentit me nr.804 prot, datë 07.12.2022 “*Informacion mbi mbledhjen e komisionit të përhershëm të histori-arkologjisë, mbi vlerësimin e kandidatëve, të cilët kanë aplikuar për titullin “akademik”,* rezulton se, më datë 05.12.2022 është mbledhur Komisioni i Përhershëm i Historisë dhe Arkeologjisë, për vijimin e procedurës për kandidatët që kanë aplikuar në fushën e arkeologjisë 2 (dy) kandidatë dhe në fushën e historisë 2 (dy) kandidatë, ku përfshihet edhe ankuesi. Referuar përmbajtjes së këtij dokumenti, i cili është nënshkruar nga ana e kryetarit të këtij komisioni dhe sekretares teknike, në mbledhje kanë marrë pjesë 7 (shtatë) anëtarë të komisionit. Në përfundim të diskutimeve, anëtarët e këtij komisioni kanë vendosur që të katërt kandidatët, përfshi edhe ankuesin, të vazhdojnë konkurimin në Seksion e më pas në Asamble.

Referuar dokumentit me nr.837 prot datë 20.12.2022 “*Informacion mbi ecurinë e procedurës së konkurimit të 5 kandidatëve që kanë aplikuar për titullin akademik, në Seksionin e Shkencave*”

Shoqërore dhe Albanologjike”, rezulton se, më datën 19.12.2022, është zhvilluar mbledhja e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA). Ky dokument është i nënshkruar nga Kryetari i SSHSHA dhe Sekretarja. Referuar përmbajtjes së dokumentit rezulton se, në mbledhjen e SSHSHA kanë marrë pjesë fizikisht 13 (trembëdhjetë) anëtarë dhe kanë dërguar votën e tyre me zarf 8 (tetë) anëtarë. Në përfundim të votimit dhe verifikimit të fletëve të votimit, ka rezultuar se, 18 (tetëmbëdhjetë) fletë votimi ishin të vlefshme dhe 3 (tre) fletë të pavlefshme. Pas numërimit të votave të vlefshme, rezultati ishte: - *Në fushën e arkeologjisë*: kandidati A.B – 12 (dymbëdhjetë) vota pro, asnjë kundër, 2 (dy) abstenime; kandidati L.P – 6 (gjashtë) vota pro, 2 (dy) kundra, 2 (dy) abstenime; - *Në fushën e historisë*: kandidati H.K – 8 (tetë) vota pro, 3 (tre) kundra, 1 (një) abstenim; ankuesi R.G – 9 (nëntë) vota pro, 2 (dy) kundra, 1 (një) abstenim; - *Në fushën e gjuhësisë*: kandidati V. M (kandidat i vetëm) – 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro, 2 (dy) kundra, 2 (dy) abstenime.

Ankuesi ka marrë pjesë në mbledhjen e datës 19.12.2022 dhe ka bërë prezantimin e tij përpara SSHSHA, por pretendon se, gjatë prezantimit të tij kanë qenë të pranishëm vetëm 9 (nëntë) anëtarë nga 21 (njëzetë e një) anëtarë, pra më pak se gjysma dhe se anëtarë të tjerë janë larguar apo janë paraqitur gjatë kësaj periudhë. Ankuesi pretendon se vendosja e emrave të anëtarëve të SSHSHA në proces verbal është e pasaktë, pasi jo të gjithë ata që kanë emrin të shënuar kanë qenë të pranishëm në prezantimin e ankuesit. Në këto kushte ankuesi ngre dyshime në lidhje me votimin e kryer prej tyre. Sipas ankuesit, mbledhja e të dhënave në lidhje me votat nuk korrespondon me numrin 21 (njëzetë e një) të pjesëmarrësve për asnjërin prej kandidatëve që kanë prezantuar përpara SSHSHA.

Në vijim të procedurës, me vendimin nr.1, datë 04.01.2023 “*Për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së ASH dhe rendin e ditës*”, Kryesia e ASH ka vendosur të thërrasë mbledhjen vjetore të Asamblesë së ASH më datën 30.01.2023 me rend dite si vijon : - Paraqitja e raportit të veprimtarisë vjetore të Akademisë së Shkencave për vitin 2022 dhe e programit të saj të punës për vitin 2023;- Pyetje dhe diskutime rreth raportit; - Zgjedhja e anëtarëve të rinj të Asamblesë. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 03.02.2023, anëtarët e Asamblesë së ASH, janë njoftuar se: “*Meqënëse për arsye objektive dhe shëndetësore mbledhja e planifikuar e Asamblesë së ASH, u shty, po ju rikujtojmë mbajtjen e saj: ditën e hënë, më 6 shkurt 2023 ora 11.00, në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave*”

Rezultoni se, në datën 06.02.2023 është mbajtur mbledhja e Asamblesë së ASH. Ankuesi pretendon se, edhe pse nuk ka asnjë pikë që ndalon kandidatët ose përfaqësuesit ligjore të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së ASH, ai nuk është thirrur të jetë prezent, ndërkohë që disa kandidatë të tjerë si A.H, A.B dhe V.M janë thirrur, kanë marrë pjesë në mbledhje në pjesën e parë dhe kanë qenë të pranishëm në mjediset e institucionit në pjesën e dytë, atë të votimit, fakt ky që sipas ankuesit rezultoi i provuar duke hapur faqen zyrtare të *facebook*-ut të Akademisë.

Gjatë mbledhjes së Asamblesë së ASH është bërë paraqitja e profileve shkencore të kandidatëve nga ana e Kryetarit të Akademisë së Shkencave. Ankuesi pretendon se, CV e tij është paraqitur nga

ana e Kryetarit të ASH në mënyrë arbitrare dhe prezantimi është bërë pa autorizimin e tij. Rezulton gjithashtu se, edhe paraqitja e profileve shkencore të kandidatëve të tjerë është realizuar nga ana e Kryetarit të ASH. Në lidhje me CV e prezantuar nga Kryetari i ASH, ankuesi pretendon se është fshirë shkollimi i tij në dy ciklet pasuniversitare, punësimi i tij, janë fshirë të gjitha kualifikimet *postdoc* në disa universitete europiane, është fshirë e gjithë veprimtaria e tij shkencore, atashimi pranë LSE dhe në Akademinë Shqiptare të Shkencave dhe Arteve në Tiranë, funksione drejtuese në IAL, organizata dhe revista. Sipas ankuesit, CV e ndërtuar nga administrata e ASH ka një përmbajtje të atillë për të krijuar idenë e një provinciali të shkolluar përciptas, pa shkollim të ciklit të dytë dhe të tretë, pa karrierë akademike në Tiranë, i pakualifikuar shkencërisht, përshtypjen e një njeriu politik dhe pa lidhje me akademizmin.

Referuar “Procesverbalit të Komisionit të Votimit “Për zgjedhjen e anëtarëve të rinj në Asamblesë e Akademisë së Shkencave” në mbledhjen e Asamblesë së Akademisë së Shkencave”, me nr.84/1 prot datë 06.02.2023, pasqyrohet procedura e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Asamblesë së ASH. Ky procesverbal është nënshkruar nga Komisioni i Votimit, i përbërë nga tri anëtarë, Akademik Emeritus F.V (Kryetar), Akademik Emeritus Dh.H (Anëtar) dhe Akademik i asociuar A.C (Anëtar). Në këtë procesverbal pasqyrohet:

“Gjithsej janë: 53 anëtarë të Asamblesë

Të pranishëm në sallë: Akademikë dhe Akademikë të Asociuar 33 dhe on-line 3.

Nga këta: Akademikë (anëtarë Emeritus) 9 dhe on-line 1.

Gjithsej votuan: 46 anëtarë të Asamblesë

Të pranishëm në votim ishin: 32 anëtarë të Asamblesë

Votuan me zarf ose në distancë, sipas nenit 10 të Statutit, 14 anëtarë të Asamblesë:

Akademikë Emeritus pjesmarrës në votim: 19 anëtarë.”

1. Në përfundim të votimit, mbas numërimit të votave, komisioni konstatoi se:

- Për marrjen e titullit “Akademik” për shkencat arkeologjike:**

<i>Emër Mbiemër</i>	<i>Raundet</i>	<i>Vota Pro</i>	<i>Vota kundër</i>	<i>Abstenim</i>	<i>Pavlefshme</i>
<i>A.B</i>	<i>Raundi i I-rë</i>	26	-	19	1
	<i>Raundi i II-të</i>	33	7	6	0
<i>L.P</i>	<i>Raundi i I-rë</i>	9	1	35	1

	<i>Raundi i II-të</i>	<i>18</i>	<i>12</i>	<i>16</i>	<i>0</i>
--	-----------------------	-----------	-----------	-----------	----------

- *Për marrjen e titullit “Akademik” për shkencën e historisë:*

<i>Emër/ Mbiemër</i>	<i>Raundet</i>	<i>Vota Pro</i>	<i>Vota kundër</i>	<i>Abstenim</i>	<i>Pavlefshme</i>
<i>R.G</i>	<i>Raundi i I-rë</i>	<i>11</i>	<i>1</i>	<i>34</i>	<i>0</i>
	<i>Raundi i II-të</i>	<i>20</i>	<i>12</i>	<i>14</i>	<i>0</i>
<i>H.K</i>	<i>Raundi i I-rë</i>	<i>23</i>	<i>2</i>	<i>21</i>	<i>0</i>
	<i>Raundi i II-të</i>	<i>25</i>	<i>10</i>	<i>10</i>	<i>1</i>

- *Për marrjen e titullit “Akademik” për shkencat e mjekësisë veterinare:*

<i>Emër/ Mbiemër</i>	<i>Vota Pro</i>	<i>Vota kundër</i>	<i>Abstenim</i>	<i>Pavlefshme</i>
<i>A.H</i>	<i>37</i>	<i>5</i>	<i>4</i>	<i>0</i>

- *Për marrjen e titullit “Akademik” për shkencën e gjuhësisë:*

<i>Emër/ Mbiemër</i>	<i>Vota Pro</i>	<i>Vota kundër</i>	<i>Abstenim</i>	<i>Pavlefshme</i>
<i>V.M</i>	<i>34</i>	<i>8</i>	<i>4</i>	<i>0</i>

2. *Komisioni i votimit, në bazë të ligjit nr.53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, neni 6,7,8 dhe Statutit të Akademisë së Shkencave, aneksi 3, në përfundim të votimit, bëri të njohur për të pranishmit në sallë dhe për ata në linjë (online) se nga katër fusha pati fitues vetëm prej tri prej tyre:*

- i. Për shkencat arkeologjike për titullin “Akademik”, prof.A.B;*
- ii. Për shkencat e mjekësisë veterinare për titullin “Akademik”, prof.A.H dhe*
- iii. Për shkencën e gjuhësisë, për titullin “Akademik”, prof.V.M.”*

Ankuesi pretendon se, ky procesverbal i mbajtur nga Komisioni i Votimit është i parregullt, pasi nuk janë firmosur fletët 1 dhe 2 të tij, por firmat e anëtarëve të Komisionit të Votimit janë vetëm në fletën 3. Sipas ankuesit ky dokument nuk është hartuar në vend për t'ju ekspozuar të gjithë anëtarëve para mbylljes së mbledhjes, por pas saj, sipas ankuesit 72 orët që patën në dispozicion administratorët akademikë për të rregulluar dokumentat në vonesë të kërkesës së tij për informacion.

Referuar listës së datës 06.02.2023, të mbajtur nga administrata e ASH, në referim të nenit 10 të Statutit të ASH, pasqyrohet lista e anëtarëve që do të votojnë me zarf. Në këtë listë pasqyrohet se, bazuar në kërkesën e vetë anëtarëve, do të votojnë me zarf për zgjedhjen e anëtarëve të rinj 4 (katër) anëtarë për shkak se ndodhen jashtë vendit (për njërin prej tyre konkretisht Akademikun K.B, është vendosur shënimi “*është paraqitur në votimin e datës 06.02.2023*”) ndërsa 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë do të votojnë me zarf për arsye shëndetësore. Me tej në këtë dokument pasqyrohet se, zarfet janë hapur nga ana e anëtarëve të komisionit të votimit në procesin e votimit në datën 06.02.2023, në prezencë të anëtarëve të Asamblesë. Ky dokument është nënshkruar për Sekretarinë e Kryesisë, nga znj. A.B, specialiste e burimeve njerëzore dhe juriste.

Me vendimin nr.6, datë 06.02.2023, Asambleja e ASH zgjodhi 3 (tre) anëtarët e rinj të Asamblesë së Akademisë së Shkencave, të cilët fituan titullin “Akademik” kandidatët e dalë fitues në përfundim të procesit të konkurimit, për shkencat arkeologjike, shkencat e zooveterinarisë, dhe shkencën e gjuhësisë. Procesi i konkurimit u mbyll pa një fitues për fushën e historisë, ku kandidonin gjithsej 2 (dy) kandidate, ankuesi R.G dhe kandidati H.K.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar gjatë procesit të konkurimit për anëtar në Asamblesë të ASH dhe marrjen e titullit “Akademik” për shkencën e historisë, nga Akademia e Shkencave, për shkak të “*vendbanimit*”, “*prejardhjes krahinore*”, “*arsye kulturore*” dhe “*vendlindjes*”.

Analiza juridike e fakteve dhe rrethanave.

Neni 18, i Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e parazisë dhe mosdiskriminimit, sanksionon: “*1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive*”.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (*Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021*)

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁶. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁷. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-

⁶ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁷ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”⁸

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetutës.

Referuar nenit 3, pika 1, të LMD, jepet përkufizimi vijues për “Diskriminimin”: “1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

Sipas LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, duke përfshirë diskriminimin e drejtëpërdrejtë dhe diskriminimin e tërthortë. Të dy këto forma të shfaqjes së diskriminimit, parashikohen nga neni 3, pikat 2 dhe 7, të LMD sipas përkufizimeve vijuese: “2. “Diskriminim i drejtëpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji. 7. “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.”

Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Referuar parashikimeve të mësipërme ligjore, diskriminimi i drejtëpërdrejtë, ndodh, kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme në bazë të një shkakut të mbrojtur. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet përmes krahasimit ndërmjet personit që pretendon se është diskriminuar dhe një personi tjetër, i cili nuk e posedon karakteristikën/shkakun e mbrojtur, të ndodhur të dy palët në një situatë të ngjashme. Ndërsa, diskriminimi i tërthortë ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, në dukje neutrale/e paanshme, e vë në disavantazh një person ose një grup personash

⁸ Shih: Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

që kanë të njëjtin shkak/shkaqe të mbrojtura. Kërkohej që të tregohet se, personi ose grupi i personave, është në disavantazh kur krahasohet me një grup krahasues. Megjithatë, në të dyja këto forma të diskriminimit, ka një ndryshim në trajtim të situatave të krahasueshme dhe se, arsyeja e këtij trajtimi është karakteristika e mbrojtur që ata posedojnë dhe që personi ose grupi me të cilin krahasohen nuk e ka. Jo në çdo rast trajtimi i diferencuar/ diferenca në trajtim përbën diskriminim. Trajtimi i diferencuar/diferenca në trajtim është diskriminues/e, nëse nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Kuadri ligjor për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave, është ligji nr.53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr.53/2019). ASH, është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh dhe krijuesish. ASH, është është një person juridik që përbëhet nga trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve. (Neni 3, i ligjit nr.53/2019). ASH si institucion, përbëhet nga organet e saj drejtuese, të cilat janë: Asambleja, Kryesia dhe Kryetari. ASH përfshin edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë saj si: Seksionet, Komisionet, Njësitë e Kërkim-Studimit, Akademia e të Rinjve, biblioteka, enti botues, si dhe administrata ndihmëse. (Neni5, i ligjit nr.53/2019).

Anëtarët (e ASH) zgjidhen nga Asambleja ndër mbajtësit e titullit “Profesor”, që kanë një kontribut të veçantë me një ndikim të gjithëpranuar në fushën përkatëse, në bazë të kandidaturave të përzgjedhura nëpërmjet procedurave e kriterëve të përcaktuara në statutin e Akademisë. Në procedurat e kandidimit e të përzgjedhjes përfshihen edhe struktura apo përfaqësues të institucioneve të kërkimit shkencor, të arsimit të lartë e të kulturës. Në raste të veçanta, anëtarë zgjidhen personalitete me kontribut të spikatur nga fusha e krijimtarisë artistike, kulturës dhe jetës sociale në përgjithësi. Si rregull, akademikët zgjidhen nga radhët e akademikëve të asociuar. Në rast kandidimi të drejtpërdrejtë, kandidati duhet të marrë mbështetjen e jo më pak se 2/3-ve të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë. (Neni 6, pika 2, ligji nr.53/2019)

Mbledhjet e Asamblesë së ASH janë të vlefshme kur në to merr pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të saj. Vendimi me shumicë të thjeshtë merret kur për të voton “pro” më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm. Zgjedhjet për personat që ushtrojnë kompetencat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 7, të ligjit nr.53/2019⁹, bëhen me votim të fshehtë dhe me shumicë absolute të të gjithë anëtarëve. Mospjesëmarrja e “anëtarëve *emeritus*”¹⁰ nuk cenon arritjen e kuorumit apo përcaktimin e shumicave të cilësuar. (Neni 8, pikat 4, 5, 6 dhe 7, të ligjit nr.53/2019)

⁹ Neni 7 “Detyrat e Asamblesë”, të ligjit nr.53/2019 parashikon: “Asambleja kryen këto detyra: 1. Zgjedh anëtarët e Akademisë. 2. Zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin, sekretarin shkencor dhe drejtuesit e seksioneve.”

¹⁰ Neni 6 “Asambleja”, pika 4, të ligjit nr.53/2019, parashikon: “4. Anëtarët e Asamblesë që mbushin moshën 75 vjeç marrin statusin e anëtarit “*Emeritus*”.

Me zgjedhjen si anëtar i Asamblesë, personi fiton titullin “akademik” ose “akademik i asociuar”. Titujt “akademik” dhe “akademik i asociuar” janë tituj akademikë dhe përfitojnë një shpërblim mujor të përhershëm për titull në masën e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. (Neni 14, ligjit nr.53/2019)

Përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 6, ligji nr.53/2019, parashikon në nenin 15, ndalesa dhe papajtueshmëri për të qenë anëtar i Asamblesë së ASH. Konkretisht, anëtarë të Asamblesë mund të zgjidhen personat deri në moshën 68 vjeç për titullin “akademik” dhe deri në 65 vjeç për titullin “akademik i asociuar”. Personat që ushtrojnë funksione drejtuese në institucionet kushtetuese apo në partitë politike nuk mund të zgjidhen anëtarë të Asamblesë. (Neni 15, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr.53/2019).

Sikurse rezulton nga parashikimi që bëhet në nenin 6, të ligjit nr.53/2019, anëtarët e Asamblesë së ASH, zgjidhen në bazë të kandidaturave të përzgjedhura nëpërmjet procedurave e kriterëve të përcaktuara në Statutin e ASH. Rezulton se, Statuti i Akademisë së Shkencave (në vijim Statuti i ASH) është miratuar me vendimin e Asamblesë së ASH nr.22, datë 18.10.2019 dhe ndryshuar më vonë me vendimet e Asamblesë së ASH nr.17, datë 21.02.2020 dhe nr.47, datë 21.07.2021. Në Statutin e ASH, bëhen këto parashikime dhe rregullime në lidhje me procedurën e konkurimit të anëtarëve të rinj të Asamblesë së ASH:

“Neni 7

Anëtarët e Asamblesë

- 2. Anëtarët e Asamblesë zgjidhen ndër mbajtësit e titullit ‘profesor’ me banim të përhershëm brenda vendit,*
- 3. Vendet e lira për kandidaturat përcaktohen nga Asambleja me propozim të kryesisë, pas konsultimeve me seksionet dhe komisionet përkatëse, duke pasur parasysh vendet e lira të krijuara, si dhe mbajtjen e një raporti të arsyeshëm përfaqësimi, midis fushave dhe nënfushave të zhvillimit të shkencës e të kërkimit shkencor.....*
- 4. Shpallja e vendeve të lira bëhet publike dhe i dërgohet IAL-ve e instituteve kërkimore 6 muaj para votimit. Ajo shoqërohet me afatet konkrete për tërë fazat kryesore të kandidimit deri në zgjedhje, të cilat përfshijnë: paraqitjen e interesit për kandidim, kohën e shqyrtimit në organet këshillimore; paraqitjen në komisionin dhe seksionin përkatës dhe koha e votimit në Asamble.*
- 5. Kandidimi bëhet nga çdo i interesuar, me mbështetjen e dy akademikëve ose dy ekspertëve, me së paku gradën “doktor i shkencave”.*
- 6. Me paraqitjen e interesit verifikohet plotësimi i kriterëve të normuara në ligjin e Akademisë së Shkencave e në këtë statut, si dhe në ligjet nr.138/2015 dhe nr.45/2015 nga një komision teknik i ngritur nga Kryesia.*
- 7. Më tej verifikohen kriteret e veçanta, që duhet të plotësojnë kandidatët, sipas parashikimeve të aneksit 2.*
- 8. Mospërbushja e kriterëve të mësipërme, të karakterit detyrues, përbën shkak për propozim të eliminimit të kandidatit, ndërsa për shkallën dhe nivelin e përmbushjes së tyre, që përbëjnë*

arsyen kryesore për shanset e zgjedhjes së çdo kandidati, shprehet seksioni me vendim. Mbledhjet e Seksionit bëhen të hapura, ku, pasi dëgjohet mendimi i propozuesve e i senatit, si dhe vlerësimet e komisionit, dëgjohet vetë kandidati. Seksioni merr vendim me votë të fshehtë. Në rast të disa kandidaturave për të njëjtin post, ato renditen sipas votave “pro” të fituara.

9. Pas shprehjes me vendim të seksioneve për çdo kandidat, kandidaturat paraqiten nga kryetari për votim në Asamble. Çdo kandidaturë shoqërohet me tërë vlerësimet e përmbledhura të organeve të organeve që janë shprehur për ta, si dhe me listën e veprimtarisë së plotë të kandidatit.

.....

11.kandidatët që konkurojnë drejtpërdrejt për “akademikë”, quhen fitues kur marrin 2/3 të votave të sa më sipër.

12. Kur për të njëjtin vend paraqiten më shumë se një kandidat, atëherë fituesi përcaktohet sipas formulës në aneksin 3 të këtij statuti

Neni 10

Anëtarët korrespondentë

3. Çdo anëtar i Asamblesë, që vendoset me banim të përhershëm jashtë vendit, kalon në statusin e anëtarit korrespondent.

4. Ky status shpallet nga kryesia brenda 1 (një) muaji nga konstatimi i këtij ndryshimi.

5. Anëtarët korrespondentë janë anëtarë të Asamblesë me të drejta të plota, plus të drejtën për të ndjekur punimet, si dhe për të votuar në distancë. Kjo e drejtë i jepet për mbledhje të veçanta edhe çdo anëtar i udhëtim jashtë vendit, apo për arsye objektive madhore.

Neni 26

Mbledhjet e Asamblesë

2. Mbledhjet quhen të rregullta kur thirren sipas këtij statuti dhe kur marrin pjesë në të mbi 1/2 e anëtarëve të Asamblesë, kuorum i cili llogaritet në bazë të numrit të anëtarëve të Asamblesë gjithsej, minus numrin e anëtarëve “Emeritus” jopjesmarrës në mbledhjen përkatëse. Formulë që shërben si bazë edhe në llogaritjen e shumicave të cilësuar.

3. Vendimet e Asamblesë merren kur për çështjen konkrete, voton “pro” mbi 50% e pjesmarrësve në votim, përveç kur në këtë statut parashikohet ndryshe.

4. Votimi bëhet i fshehtë për zgjedhjen e anëtarëve të Asamblesë e të Kryesisë.

5. Anëtarët, për arsye të përcaktuara në këtë statut, mund të votojnë edhe në distancë, elektronikisht apo me postë. Për çështje jozgjedhore vota shoqërohet me një arsytim të shkurtër, me shkrim, të votës “pro” ose “kundër” që i paraqitet Asamblesë.

6. Lista e personave që do të votojnë si më sipër, i bëhet e njohur Asamblesë, një javë para mbledhjes.

7. Pjesmarrësit në votim, në distancë, përveç anëtarëve korrespondentë, nuk llogariten në plotësimin e kuorumit të hapjes së mbledhjes.

Neni 34

Seksionet

Me qëllim organizimin e punës dhe realizimin më të mirë të funksioneve të saj, anëtarët e Asamblesë rigrupohen në seksione sipas grup-fushave kryesore.

Neni 35

Organizimi i seksioneve

Akademia e Shkencave ka në përbërje të saj këto seksione:

- *Seksioni i Shkencave Shoqërore Albanologjike*
- *Seksioni i Shkencave Natyrore-teknike*

Hapja ose mbyllja e një seksioni bëhet vetëm me propozim të kryesisë e me vendim të Asamblesë.

Neni 38

Mbledhjet e seksionit

3. Mbledhjet e Seksionit bëhen kur në të merr pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Votimi, si rregull, bëhet i hapur, përveçse kur votohet për pranimet e reja.

Neni 39

Komisionet

Komisionet e përhershme ngrihen pranë ASH-së, me anëtarë të së njëjtës fushë ose të fushave të përafërta, me qëllim mundësimin e një komunikimi e një debati më të specializuar.

Neni 43

Mbledhjet e Komisionit

3. Mbledhjet janë të rregullta, kur thirren me një rend dite, lajmërohen 3 (tri) ditë para dhe në to marrin pjesë mbi gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e të pranishmëve.

Në Aneksin 2, i cili është pjesë përbërëse e Statutit të ASH, përcaktohen kriteret specifike dhe procedurat e vlerësimit të tyre për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Akademisë. Në këtë Aneks, përcaktohet se, kandidatët që konkurojnë për anëtarë të Asamblesë (akademikë, akademikë të asociuar), duhet të plotësojnë paraprakisht kriteret normative të përcaktuara në ligjin e ASH-së dhe në Statut, që lidhen me integritetin e figurës, titullin, moshën, vendbanimin dhe origjinën, ndërsa në pikën 1.1, të Aneksit 2, të Statutit, parashikohen kriteret specifike që duhet të plotësojë kandidati që konkuron për të qenë anëtar i Asamblesë. Në pikën 1.2, të Aneksit 2, të Statutit, parashikohet procedura e vlerësimit të kandidaturave dhe kriterëve specifike, ku përcaktohet se:

“ Kriteri i kohës së fitimit të titullit shkencor paraprakisht nga komisioni teknik, sipas nenit 7, pika 6 e Statutit të ASH. Kandidati që nuk plotëson kushtin e 8 (tetë) vjetëve nga fitimi i titullit profesor nuk kualifikohet. Për kandidatët e tjerë veprohet si më poshtë.

Njësia bazë universitare a kërkimore ku punon kandidati, ose ka ushtruar aktivitetin kryesor, jep një vlerësim të motivuar për plotësimin ose jo të kriterëve specifike nga kandidati, ndërsa senati apo këshilli shkencor, ku kandidati ka fituar titullin, shprehet me votë konsultative për mbështetjen ose jo të kandidaturës.

Komisioni përkatës pranë ASH-së bën vlerësimin e shkallës së plotësimit të kriterëve të mësipërme, duke u shprehur në mënyrë të detajuar për secilën nga rubrikat dhe pasqyruar më vete, aktivitetin pas marrjes së titullit “Profesor.

Në rast të mosplotësimit të një ose disa prej këtyre kërkesave, në masë të krahasueshme me ato të fitimit të titullit “profesor”, Komisioni mund të rekomandojë mosmbështetjen e kandidaturës.

Vlerësimet e njësisë, komisionit dhe mendimi i senatit (këshillit) i përcillen Seksionit, i cili vazhdon procedurën, sipas statutit, për kandidatët që plotësojnë kriteret.

Vlerësimet e njësisë bazë e të komisionit të ASH-së kanë karakter teknik, në verifikimin e plotësimit formal të kriterëve, si: numri i punimeve, indeksimi i revistave e enteve botuese, numri i citimeve etj.

Ndërsa për vlerën e rëndësinë e aktivitetit në tërësi, si dhe për integritetin e tyre profesional të kandidatëve shprehet senati (këshilli shkencor) dhe Seksioni i ASH-së.”

Aneksi 3, i Statutit, parashikon dhe rregullon procedurat e votimit dhe përcaktimit të fituesit për zgjedhjen e Kryetarit, anëtarëve të Kryesisë dhe të anëtarëve të Akademisë. Ndër të tjera, në Aneksin 3, i cili është pjesë përbërëse e Statutit të ASH, bëhen këto parashikime:

“Përcaktime:

Me mbi 50% të votave d.t.th se numri i votave “pro” duhet të jetë më i madh se ½ e numrit (të anëtarëve gjithsej minus numrin e anëtarëve Emeritus që nuk marrin pjesë në votim).

Me mbi 50% të votave gjithsej d.t.th.se numri i votave “pro” duhet të jetë më i madh se ½ e numrit të pjesmarrësve në votim.”

.....

Zgjedhja e anëtarëve të rinj

Për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Asamblesë e ata të jashtëm ndiqet e njëjta procedurë dhe mënyrë përlllogaritje si për anëtarët e kryesisë, me ndryshimin, që në raundin e dytë për anëtarët e rinj fitues duhet të ketë marrë mbi 50% të votave.

Për kandidatët që kandidojnë direkt për “Akademik” në raundin e parë, duhet të ketë marrë jo më pak se 2/3 e votave, ku si numër votash merret ai i përcaktuar në paragrafin 1, të këtij aneksi.

Në aneksin 3, të Statutit, bëhen parashikimet e mëposhtme në lidhje me procedurën e votimit dhe mënyrën e përlllogaritjes dhe përcaktimit të fituesit:

“ Në rastin kur për funksionin përkatës ka një kandidat.

*Në këtë rast votohet me një raund ku çdo pjesmarrës shprehet me **Po** ose **JO** për kandidaturën. Kandidati shpallet fitues në rast se merr “pro” mbi 50 % të votave.*

Në rastin me dy kandidatë.

Në këtë rast votohet me një fletë votimi që përmban dy raunde votimi.

*Në të parin votohet se cili nga kandidatët është më i mbështetur duke vendosur **X** përbri emrit të tij.*

Raundi i parë

<i>Emri, mbiemri</i>	<i>PO</i>
<i>Kandidati 1</i>	<i>X</i>
<i>Kandidati 2</i>	<i>.....</i>

*Në raundin e dytë, çdo anëtar voton për secilin kandidat me **PO** ose **Jo**, sikur të ishte kandidat i vetëm, duke vendosur shenjën **X** përbri opsionit të zgjedhur, pra çdo anëtar ka dy vota.*

Raundi i dytë

<i>Emri, mbiemri</i>	<i>PO</i>	<i>Jo</i>
<i>Kandidati 1</i>	<i>X</i>	

<i>Emri, mbiemri</i>	<i>PO</i>	<i>Jo</i>
<i>Kandidati 2</i>	<i>X</i>	

Kandidat fitues quhet ai që ka fituar mbi 50% të votave “pro” në raundin e parë ose ai prej kandidatëve, duke filluar nga i pari, që në raundin e dytë ka fituar “pro” mbi 50% të votave gjithsej.

.....”

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe rrethanave të konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës, pretendimeve të ankuesit, si dhe kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon procesin e konkurimit dhe pranimit të anëtarëve të rinj në Asamblenë e ASH dhe fitimin e titullit “Akademik”, Komisioneri konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

Në bazë të informacionit dhe provave të administruara rezulton se, ankuesi ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në ligjin nr.53/2019, si dhe kriteret specifike të parashikuara nga Statuti i ASH. Pretendimet e ankuesit, kanë të bëjnë me momentin e procedurës së vlerësimit dhe procesin e votimit në strukturat përkatëse dhe Asamblenë e ASH. Në procedurën e konkurimit, kanë plotësuar kriteret dhe kanë vijuar procedurën e vlerësimit dhe votimit njësoj si ankuesi edhe 5 (pesë) kandidatë të tjerë, pra në procedurë kanë qenë gjithsej së bashku me ankuesin 6 (gjashtë) kandidatë. Në fushën e historisë, ku edhe ka kandiduar ankuesi, në procesin e vlerësimit dhe votimit, ka patur 2 (dy) kandidatura gjithsej, ankuesi dhe kandidati H.K. Procedura e ndjekur në Seksion, Komision dhe Asamblenë e ASH ka qenë e njëjtë për të gjithë kandidatët, ankuesin dhe 5 (pesë) kandidatët e tjerë. Në përfundim të gjithë procedurës së zhvilluar për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Asamblesë së ASH, nga 4 fushat e shkencës të përfshira në konkurim, ka patur

fitues për 3 prej tyre, ndërsa nuk ka patur fitues për fushën e historisë, ku ka kandiduar ankuesi dhe kandidati H.K.

Pretendimet e ankuesit në lidhje me procedurën e konkurimit, që është objekt kundërshtimi nga ana e tij, konsistojnë që në momentin kur është bërë vlerësimi i kandidaturave nga komisioni i përhershëm, në rastin e ankuesit, nga Komisioni i Përhershëm i Historisë dhe Arkeologjisë. Ankuesi pretendon se, vlerësimi i tij është bërë nga një komision i përbërë nga persona jo kompetentë dhe me gradë më të ulët se sa titujt e tij akademikë. Sipas ankuesit, ky komision është krijuar *ad hoc* dhe jo me konkurim, por sipas preferencave të Kryetarit, me emërim. Gjithashtu, ankuesi pretendon se, mbledhja e zhvilluar nga ky komision për vlerësimin e kandidaturave nuk ka qenë e ligjshme pasi në mbledhje kanë marrë pjesë 7 (shtatë) anëtarë nga 14 (katërmëdhjetë), pra 50% dhe jo 51%. Në lidhje me shqyrtimin nga Komisioni i Përhershëm i Historisë dhe Arkeologjisë, ankuesi ngre gjithashtu pretendimin se, kualifikimet e dhëna për të nga së paku dy prej anëtarëve janë të mbarsura me paragjykime ideologjike dhe të pavërteta (duke e konsideruar një studiues të ri), që nuk janë sipas tij të lejueshme në një institucion si ASH. Në këtë komision nuk është bërë asnjë ekspertizë, por janë thënë opinione individuale, mendime krejt personale, shpeshherë të mbarsura me paragjykime kulturore të vjetëruara. Një fakt i tillë sipas tij gjen pasqyrim në proces-verbalin e mbledhjes së këtij komisioni dhe tregon për klimën e krijuar.

Referuar parashikimeve që bëhen në nenet 39, 40 dhe Aneksin 4, të Statutit të ASH, rezulton se Komisioni i Historisë dhe Arkeologjisë, është një komision i përhershëm shkencor i ngritur pranë ASH dhe jo një komision *ad hoc*. Referuar nenit 42, të Statutit, përcaktohet se, përbërja përfundimtare e komisioneve shpallet nga Kryesia dhe procedura për përcaktimin e anëtarëve nuk parashikon ndonjë proces votimi. Hetimi dhe verifikimi në lidhje me legjitimitetin e ngritjes së komisionit nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në çështjen në shqyrtim.

Referuar informacionit të mbajtur nga Komisioni i Përhershëm i Historisë dhe Arkeologjisë me nr.804, datë 07.12.2022, pasqyrohet se, në mbledhje kanë marrë pjesë 7 (shtatë) anëtarë dhe në të pasqyrohet se, mbledhja filloi duke qenë të pranishëm gjysma e anëtarëve, pra duke interpretuar në këtë mënyrë se, pjesëmarrja e gjysmës së anëtarëve të komisionit në mbledhje përbën kuorumin e nevojshëm për të zhvilluar takimin.

Në lidhje me kuorumin e kërkuar për të konsideruar të rregullta mbledhjet e Komisioneve, në nenin 43, pika 3, e Statutit të ASH përcaktohet se, mbledhjet janë të rregullta, kur marrin pjesë mbi gjysma e anëtarëve.

Bazuar në informacionin e Komisionit të Përhershëm të Historisë dhe Arkeologjisë, si dhe të dhënave të administruara nga faqja zyrtare e ASH¹¹ në lidhje me përbërjen e këtij komisioni, rezulton se, Komisioni i Historisë dhe Arkeologjisë ka në përbërjen e tij 14 (katërmëdhjetë) anëtarë. Në takimin e zhvilluar në datën 05.12.2022, kanë marrë pjesë 7 (shtatë) anëtarë nga 14

¹¹ <https://akad.gov.al/ash/component/content/article/2-uncategorised/696-komisioni-i-historise-arkeologjise>

(katërbëdhjetë) anëtarë në total që ka ky komision, pra gjysma e anëtarëve. Sa më sipër, rezulton se, mbledhja e zhvilluar në datën 05.12.2023, nuk mund të konsiderohet e rregullt referuar parashikimit të nenit 43, pika 3, të Statutit të ASH, ku kërkohet se, që një mbledhje të konsiderohet e rregullt, duhet të marrin pjesë mbi gjysma e anëtarëve. Pra, kjo mbledhje do të konsiderohej e rregullt nëse do të kishin marrë pjesë minimalisht 8 (tetë) anëtarë, ndërkohë që kanë marrë pjesë 7 (shtatë) anëtarë. Nga ana tjetër, rezulton se, në mbledhjen e zhvilluar nga Komisioni i Historisë dhe Arkeologjisë janë marrë në shqyrtim dhe janë vlerësuar kandidatët në fushën e arkeologjisë (2 kandidatë gjithsej) dhe të fushës së historisë (2 kandidatë gjithsej, ku përfshihet edhe ankuesi).

Ankuesi nuk shprehet konkretisht se cilët janë anëtarët e komisionit dhe konkretisht shprehjet që, ai pretendon se janë jo profesionale apo të mbarsura me paragjykime kulturore të vjetëruara. Nga kqyrja e informacionit nr.804 prot, datë 07.12.2022, ku janë pasqyruar diskutimet e anëtarëve të Komisionit të Përhershëm të Historisë dhe Arkeologjisë, rezulton se, në përfundim të diskutimeve, anëtarët prezent të komisionit kanë vlerësuar kandidaturat dhe punimet e tyre, njohjet dhe bashkëpunimet shkencore me ta, duke vendosur që të 4 (katër) kandidatët, 2 (dy) nga fusha e historisë dhe 2 (dy) nga fusha e arkeologjisë, të vazhdojnë konkurimin në Seksion e më pas në Asamble. Nuk rezulton që të ketë patur anëtarë të komisionit të cilët kanë shprehur kundërshtime për vazhdimin e konkurimit për ndonjërin nga kandidatët, përfshi ankuesin. Në lidhje me vlerësimet e bëra nga anëtarë të caktuar të këtij komisioni, Komisioneri gjykon se, nuk është në fushën e tij të ekspertizës që të vlerësojë nëse ato janë profesionale apo jo.

Ankuesi pretendon se, në mbledhjen e datës 19.12.2022 të SSHSHA, nuk kanë marrë pjesë fizikisht 13 (trembëdhjetë) anëtarë sikurse pasqyrohet në shkresën me nr. 837 prot, datë 20.12.2022, por gjatë paraqitjes që ai ka bërë në SSHSHA kanë qenë të pranishëm 9 (nëntë) anëtarë. Në kushtet kur, pretendimi i ankuesit në lidhje me numrin e anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhjen e SSHSHA të datës 19.12.2022 nuk rezultoi i bazuar dhe i provuar në ndonjë akt apo provë, Komisioneri vlerëson se, shkresa me nr. 837 prot datë 20.12.2022, e nënshkruar nga Kryetari dhe Sekretarja e SSHSHA, e paraqitur nga ASH në cilësinë e provës, është akti i vetëm zyrtar që tregon në lidhje me numrin e pjesëmarrësve në këtë mbledhje dhe prezumohet një akt i ligjshëm për sa kohë që nuk është provuar e kundërta.

Referuar shkresës nr. 837 prot, datë 20.12.2022, numri total i anëtarëve që kanë votuar është 21, (njëzetë e një) nga të cilët 13 (trembëdhjetë) fizikisht dhe 8 (tetë) e kanë dërguar votën e tyre në zarf të mbyllur. Nga numri total i votave 21 (njëzetë e një) të tilla, ka rezultuar që, vetëm 18 (tetëmbëdhjetë) fletë-votimi kanë qenë të vlefshme, pasi 3 (tre) fletë-votimi kanë rezultuar të pavlefshme. Në fushën e historisë ku ka kandiduar ankuesi, ky i fundit ka marrë 9 (nëntë) vota pro, 2 (dy) kundra dhe 1 (një) abstenim, ndërsa kandidati tjetër H.K, ka marrë 8 (tetë) vota pro, 3 (tre) kundra dhe 1 (një) abstenim; në fushën e arkeologjisë, ku gjithashtu ka patur 2 (dy) kandidatura, kandidati A.B ka marrë 12 (dymbëdhjetë) vota pro, asnjë kundër dhe 2 (dy) abstenime, kurse kandidati tjetër L.P, ka marrë 6 (gjashtë) vota pro, 2 (dy) kundra dhe 2 (dy) abstenime; në fushën e gjuhësisë, ku kandidat i vetëm ka qenë V.M, ky i fundit ka marrë 17

(shtatëmbëdhjetë) vota pro, 2 (dy) kundra dhe 2 (dy) abstenime. Sa më sipër konstatohet se, numri i votave për kandidatët në raport me numrin e votave të vlefshme, nuk përputhen. Kjo mospërputhje konstatohet për kandidatët në të tre fushat e shqyrtuara nga SSHSHA, si për fushën e arkeologjisë dhe të historisë (ku ka kandiduar ankuesi), në të cilat ka patur më shumë se një kandidat, ashtu edhe për fushën e gjuhësisë, ku ka patur vetëm një kandidat.

Në lidhje me procesin e votimit të zhvilluar në datën 19.12.2022 në SSHSHA, ankuesi ngre gjithashtu dyshime në lidhje me garancinë e votës dhe tjetërsimin e saj në lidhje me anëtarët që nuk kanë qenë prezent në votim, por kanë votuar në distancë. Sipas tij, nuk ekziston një procesverbal dhe asnjë dëshmi, se anëtarët e Komisionit Zgjedhor të kenë shkuar në mënyrë të protokolluar për të marrë votën e anëtarëve të pamundur nëpër shtëpitë e tyre. Nuk ka informacion se ku e kanë hedhur votën dhe si është ruajtur vota e anëtarëve që kanë ardhur paraprakisht për të votuar në Sekretarinë e ASH. Nuk ka një procesverbal të marrjes dhe hapjes së fletëve të votimit të deleguara.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, ASH nuk vendosi në dispozicion ndonjë akt tjetër në lidhje me procesin e votimit të datës 19.12.2022 në SSHSHA, përveç shkresës nr.837 prot datë 20.12.2022, nëpërmjet të cilës SSHSHA, ka informuar Kryesinë dhe Kryetarin e ASH, mbi ecurinë e procedurës së konkurimit. Në këtë shkresë pasqyrohet se, bashkëlidhur gjendet dokumentacioni i fletëve të votimit dhe numërimit, si dhe firmat e komisionit administrues dhe numërues të fletëve të votimit, akte këto që nuk janë vendosur në dispozicion nga ASH.

Referuar Statutit të ASH, nuk ka parashikime për votimin e anëtarëve të pamundur nëpër shtëpitë e tyre, për votim në sekretarinë e ASH, apo për votim të deleguar. Statuti, përmban parashikime për votim në distancë, elektronikisht apo me postë, në rast se anëtari ndodhet jashtë shtetit ose për arsye të tjera pamundësie, siç është gjendja shëndetësore.

Referuar parashikimeve të bëra në Statut në lidhje me votimin në distancë (nenet 10 dhe 26 të Statutit) rezulton se këto parashikime kanë të bëjnë me votimin e anëtarëve në mbledhjet e Asamblesë së ASH. Në dispozitat e Statutit të ASH që rregullojnë veprimtarinë dhe vendimarrjen e Seksioneve, si në rastin e SSHSHA, nuk ka parashikime për votim në distancë për anëtarët e Seksionit që nuk janë prezent fizikisht në mbledhje.

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua ndonjë procesverbal i mbajtur nga ana e Komisionit të Votimit në lidhje me administrimin e votave të dërguara me zarf nga anëtarët jo prezent në votim. Gjithashtu, nga ana e ASH nuk u dha ndonjë shpjegim në lidhje me mënyrën e ruajtjes së votave të anëtarëve të cilët e kanë dërguar votën e tyre me zarf. Referuar Statutit të ASH, nuk konstatohet se ka parashikime mbi mënyrën se si rregullohet ky moment i procedurës. Referuar shkresës nr.86 prot datë 08.02.2023, nëpërmjet të cilës ASH i ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion të paraqitur nga ankuesi pas përfundimit të procesit të konkurimit, sqarohet se: “3. *Lista e anëtarëve të Asamblesë që kanë votuar me prani fizike dhe me votë të mbyllur në zarf për arsye objektive (votë e autosekretuar) gjendet në praktikën e komisionit të zgjedhjeve.5. Nuk*

ka parashikime në Statut për votim në sekretarinë e Kryesisë, por, sipas listës së miratuar për anëtarët që për arsye objektive (jashtë vendit a për arsye shëndetësore) dërgojnë votën me zarf, votat depozitohen në sekretari e iu dorëzohen komisionit para Asamblesë, i cili i hap ato publikisht e pasi verifikon sekretimin në prezencën e një flete të vetme, e vendos atë në kuti. Asnjë anëtar nuk ka vënë në dyshim keqpërdorimin e votës së tij shkeljen e fshehtësisë së saj.”

Ankuesi pretendon se, ASH nuk ka paraqitur publikisht në faqen e saj kopjen e listës së anëtarëve të Akademisë që kanë votuar paraprakisht dhe atyre që kanë marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë dhe nuk ka ekspozuar as listën e fletëve të votimit të deleguar të nisur për votimin në Seksion në datën 19.12.2022.

Neni 26, pika 6, e Statutit, vendos detyrimin që lista e personave që do të votojnë në distancë, elektronikisht apo me postë, t’i bëhet e njohur Asamblesë, një javë para mbledhjes. Statuti i ASH nuk ka parashikime që lista të bëhet publike, por t’i bëhet njohur Asamblesë 1 (një) javë para mbledhjes. Pavarësisht se, sikurse është pasqyruar edhe më sipër, nuk rezulton që Statuti të përcaktojë shprehimisht votimin në distancë në Seksionet e ASH, në kushtet kur një procedurë e tillë është zbatuar në praktikë, do duhet që një detyrim i tillë të gjejë zbatim edhe për mbledhjen e Seksionit. Nuk rezulton që, lista e anëtarëve të SSHSHA që kanë votuar në distancë duke dërguar votën e tyre në zarf të mbyllur në mbledhjen e datës 19.12.2022, të jetë bërë e njohur për anëtarët e SSHSHA përpara mbledhjes së datës 19.12.2022. Lista e anëtarëve të SSHSHA që kanë votuar në distancë në datën 19.12.2022, gjen pasqyrim vetëm në shkresën nr.837 prot., datë 20.12.2022, që është një informacion që ky seksion ka bërë në lidhje me procedurën dhe votimin e kryer në datën 19.12.2022.

Pavarësisht pretendimeve të ankuesit për parregullsi gjatë vlerësimit dhe votimit të kryer nga SSHSHA, ai rezulton të ketë marrë më shumë vota “pro” krahasimisht me kandidatin tjetër H.K.

Ankuesi pretendon se, vota superiore që ai ka fituar ndaj kandidatit H.K, në votimin e realizuar në datën 19.12.2022 përpara SSHSHA, sipas rregullave akademike (neni7, pika 8 e Statutit) do të duhej të kushtëzonte rankimin që u paraqitet anëtarëve të Asamblesë në votimin final në fletën e votimit. Rreshtimi i kandidatëve në fletën e votimit, sipas Statutit të ASH, neni 7, pika 8, u jep mundësi anëtarëve të Asamblesë së ASH, të kuptojnë rankimin që ka caktuar Seksioni i Specializuar në Shkencat Humane, kur kandidatët kryejnë prezantimin e karrierës së tyre. Sipas ankuesit, duhej që fituesi i datës 19.12.2022, të vendosej i pari, por ka ndodhur e kundërta. Në vend që ai si fitues, të rankohej në vendin e parë, qëllimisht nga administrata e ASH është vendosur në vendin e dytë, duke i ofruar kështu, anëtarëve të Asamblesë së Akademisë që ishin votues, një imazh dhe kujtesë të përmbysur të rezultateve të vlerësimit të Seksionit të Shkencave Humane.

Neni 7, i Statutit të ASH, përmban parashikime mbi mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Asamblesë së ASH. Pika 8, e nenit 7 të Statutit, përmban parashikime në lidhje me vlerësimin që i bëhet kandidatëve nga Seksioni përkatës i ASH, që në rastin e ankuesit duke mbajtur në konsideratë fushën e shkencës ku ai ka aplikuar, që është ajo e historisë, është bërë nga SSHSHA.

Në pikën 8, të nenit 7, të Statutit të ASH, shprehimisht përcaktohet: *“Mospërmbushja e kritereve të mësipërme, të karakterit detyrues, përbën shkak për propozim të eliminimit të kandidatit, ndërsa për shkallën dhe nivelin e përmbushjes së tyre, që përbëjnë arsyen kryesore për shanset e zgjedhjes së çdo kandidati, shprehet seksioni me vendim. Mbledhjet e Seksionit bëhen të hapura, ku, pasi dëgjohet mendimi i propozuesve e i senatit, si dhe vlerësimet e komisionit, dëgjohet vetë kandidati. Seksioni merr vendim me votë të fshehtë. Në rast të disa kandidatave për të njëjtin post, ato renditen sipas votave “pro” të fituara.”*

Formulimi i nenit 7, pika 8, të Statutit të ASH, nuk përcakton se ku bëhet renditja e kandidatëve sipas votave “pro” të fituara në Seksion. Neni 7, pika 8, e Statutit të ASH, nuk ka një parashikim se, votat “pro” të fituara nga kandidatët, në rastet kur ka më shumë se një kandidat, vendosin rankimin e kandidatëve në fletën e votimit gjatë procesit të votimit në mbledhjen e Asamblesë. Në parashikimet që bëhen në Aneksin 3, të Statutit të ASH, ku parashikohet procedura e votimit dhe përcaktimi i fituesit, si dhe ku përcaktohet modeli i fletës së votimit, nuk ka asnjë parashikim në lidhje me faktin, nëse kandidatët në fletën e votimit renditen sipas votave “pro” të fituara nga votimi në Seksionin përkatës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar dhe konkretisht fletëve të votimit të përdorura në votim në mbledhjen e Asamblesë së ASH, të cilat u depozituan gjatë shqyrtimit të ankesës nga ana e ankuesit, rezulton se, janë përdorur tre fletë votimi, nga të cilat, një për votimin e kandidatëve në fushën e arkeologjisë, një për votimin e kandidatëve në fushën e historisë dhe një për votimin e kandidatëve në fushën e zooveterinarisë dhe gjuhësisë. Fleta e votimit për dy fushat e fundit, atë të zooveterinarisë dhe gjuhësisë, nuk do të merren në analizë pasi në këto fusha ka patur nga një kandidat të vetëm në konkurim dhe në referim të Statutit të ASH, fleta e votimit është e ndryshme nga ajo kur ka më shumë se një kandidat.

Referuar fletës së votimit për votimin në fushën e arkeologjisë, ku ka patur 2 kandidatë, është renditur i pari kandidati A.B dhe i dyti kandidati L.P. Nga aktet rezulton se, kandidati A.B i cili është renditur i pari në fletën e votimit në raundin e parë, ka marrë më shumë vota “pro” gjatë votimit në SSHSHA në krahasim me kandidatin L.P, i cili është renditur i dyti në fletën e votimit në raundin e parë. Nga shqyrtimi i fletës së votimit të përdorur për fushën e historisë ku në votim kanë qenë ankuesi dhe kandidati H.K, rezulton se, kandidati H.K, i cili ka marrë më pak vota “pro” në votimin në SSHSHA krahasimisht me ankuesin, është renditur i pari në fletën e votimit në raundin e parë, ndërsa ankuesi është renditur i dyti.

Ankuesi pretendon se, rreshtimi i kandidatëve në fletën e votimit është një detyrim sipas pikë 8, të nenit 7, të Statutit të ASH, dhe se, renditja e kandidatëve sipas numrit të votave “pro” të marra në votimin që kryehet në Seksion, u jep mundësi anëtarëve të Asamblesë së ASH, të kuptojnë rankimin që ka caktuar Seksioni, si një organ i specializuar në fushën respektive ku ka kandiduar kandidati. Duke u rankuar qëllimisht në vendin e dytë dhe jo në të parin në fletën e votimit të datës 06.02.2023, i është ofruar anëtarëve të Asamblesë së Akademisë që ishin votues, një imazh dhe kujtesë e përmbysur e rezultateve të vlerësimit të Seksionit të Shkencave Humane.

Komisioneri konstaton se, formulimi i pikës 8, të nenit 7, të Statutit të ASH, si dhe parashikimet e bëra në Aneksin 3, të Statutit, nuk të çojnë në përfundimin se, renditja e kandidatëve në fletën e votimit sipas numrit të votave “pro” të marra në votimin që kryehet në Seksion, është një detyrim që rrjedh nga Statuti apo që është tregues i vlerësimit që është bërë në Seksion.

Referuar nenit 7, pika 9, të Statutit parashikohet se, pas shprehjes me vendim të seksioneve për çdo kandidat, kandidaturat paraqiten nga Kryetari për votim në Asamble, dhe çdo kandidaturë shoqërohet me tërë vlerësimet e përmbledhura të organeve që janë shprehur për ta. Në këtë kontekst, pika 9, e nenit 7, të Statutit mundëson që anëtarët e Asamblesë së ASH që janë votues të marrin dijeni në lidhje me vlerësimet e organeve që janë shprehur për kandidatët.

Në këto rrethana, pavarësisht situatës faktike të konstatuar me fletët e votimit, nuk mund të arrihet në përfundimin se, ka një shkelje të pikës 8, të nenit 7 të Statutit e për rrjedhojë, ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme.

Ankuesi ngre pretendime në lidhje me sigurinë e procesit të votimit të datës 06.02.2023 dhe garancisë së votës. Sipas tij, ASH nuk ka të parashikuar asnjë mbi mënyrën e prodhimit, dokumentimit, shënimit të elementëve të sigurisë dhe marrjes në ruajtje të fletëve të votimit. Nuk dihet se ku janë prodhuar fletët e votimit, ku janë ruajtur ato. Nuk ka një procesverbal të prodhimit të fletëve të votimit dhe elementët e sigurisë të përcaktuar nga Kryesia e ASH paraprakisht.

Gjithashtu, marrja në dorëzim dhe numërimi i fletëve të votimit për anëtarët që nuk kanë mundur të paraqiten në mbledhjen e Asamblesë nuk është bërë përmes një komisioni me procesverbal, fletët e votimit nuk janë ruajtur në një vend të sigurt, të vulosur nga anëtarët e komisionit. Ankuesi pretendon se, nga anëtarë të Komisionit Zgjedhor i ishte deklaruar se, fletët e votimit të kandidatëve që kishin votuar me zarf për shkak të pamundësisë për të qenë prezent në votim, ishin ruajtur në paradhomën e Kryetarit të ASH, në një dosje të hapur dhe lehtësisht të prekshme, për shkak të mungesës së vulave të dyllosura dhe ruajtjes në kasaforta që hapeshin vetëm nga anëtarët e ngarkuar të komisionit. Komisioni i numërimit, më pas i ka marrë ato nga zyra e Kryetarit të ASH dhe i ka futur në kutinë e votimit para fillimit të votimit të anëtarëve të Asamblesë dhe i ka ligjëruar, pa ditur origjinën e tyre dhe as mënyrën e sekretimit. Ankuesi pretendon gjithashtu se, nga verifikimi i fletëve të votimit dhe procesverbalit të mbajtur, ku pasqyrohet se kanë votuar me zarf 14 (katërmëdhjetë) anëtarë, në dokumentet zgjedhore ndodheshin vetëm 10 (dhjetë) zarfe, ndërkohë që duhet të ishin 14 (katërmëdhjetë) të tillë. Ankuesi deklaron se i është mohuar marrja e fletëve të votimit për t'i paraqitur si provë.

Sipas ankuesit, strukturimi i fletës së votimit është i paqartë dhe se askush nuk e kupton arsyetimin e përmbajtjes së fletës së votimit, strukturimin në një fletë dhe në një raund, të dy të ashtuquajturve raunde votimi. Ankuesi pretendon se një gjë e tillë ndodh për ta patur më të lehtë mundësinë e dirigjimit në finale të procesit, sikurse ka ndodhur edhe në datën 6.02.2023.

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua ndonjë procesverbal i mbajtur nga ana e Komisionit të Votimit në lidhje me administrimin e votave të dërguara me zarf nga anëtarët jo prezent në

votim. Gjithashtu, nga ana e ASH nuk u dha ndonjë shpjegim në lidhje me mënyrën e ruajtjes së votave të anëtarëve të cilët e kanë dërguar votën e tyre me zarf. Referuar Statutit të ASH, nuk konstatohet se ka parashikime mbi mënyrën se si rregullohet ky moment i procedurës. Referuar shkresës nr.86 prot, datë 08.02.2023, nëpërmjet të cilës ASH i ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion të paraqitur nga ankuesi pas përfundimit të procesit të konkurimit, sqarohet se: “3. Lista e anëtarëve të Asamblesë që kanë votuar me prani fizike dhe me votë të mbyllur në zarf për arsye objektive (votë e autosekretuar) gjendet në praktikën e komisionit të zgjedhjeve.5. Nuk ka parashikime në Statut për votim në sekretarinë e Kryesisë, por, sipas listës së miratuar për anëtarët që për arsye objektive (jashtë vendit a për arsye shëndetësore) dërgojnë votën me zarf, votat depozitohen në sekretari e iu dorëzohen komisionit para Asamblesë, i cili i hap ato publikisht e pasi verifikon sekretimin në prezencën e një flete të vetme, e vendos atë në kuti. Asnjë anëtar nuk ka vënë në dyshim keqpërdorimin e votës së tij shkeljen e fshehtësisë së saj.”

Ankuesi pretendon se, ASH nuk ka paraqitur publikisht në faqen e saj kopjen e listës së anëtarëve të Akademisë që kanë votuar paraprakisht dhe atyre që kanë marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë dhe nuk ka ekspozuar as listën e fletëve të votimit të deleguar të nisur për votimin në datën 06.02.2023.

Statuti i ASH, në nenin 26, pika 6, vendos detyrimin që lista e personave që do të votojnë në distancë, elektronikisht apo me postë, t’i bëhet e njohur Asamblesë, një javë para mbledhjes. Statuti nuk ka parashikime që lista të bëhet publike, por t’i bëhet njohur Asamblesë 1 (një) javë para mbledhjes. Referuar akteve të administruara, rezulton se nuk është respektuar ky detyrim, pasi lista me anëtarët e Asamblesë së ASH që do të votojnë në distancë është paraqitur vetëm në datën 06.02.2023, fakt ky që rezulton i provuar sipas listës me të njëjtën datë të nënshkruar nga punonjësja e administratës së ASH.

Pretendimet e ankuesit, në lidhje me deklaratimet që ai pretendon se i janë bërë nga anëtarët e Komisioni Zgjedhor apo të dhënat në lidhje me numrin e fletëve të votimit, nuk u provuan.

Sipas ankuesit, ASH është e titulluar nga ligji që t’i sigurojë gjithsecilit kandidat, konkurim të lirë, të bazuar para së gjithash në meritokraci, që do të duhet të përcaktohet përmes Instrumentit të Vlerësimit (Dokument i posaçëm që imponon ligji, të cilin ASH nuk e disponon). Ky dokument sipas ankuesit duhet të ishte konceptuar me elementë që vlerësojnë punën dhe veprimtarinë shkencore të kandidatit, prezantimin e tyre vetë para anëtarëve të Akademisë, të cilët do të duhet të votojnë më pas kandidatin me performancën më të lartë, të ardhur prej pikëzimit të realizuar nga instrumenti i vlerësimit dhe jo atë që siguron më shumë mbështetje nga Kryetari i ASH dhe kryen lobime në prapaskenë.

Duke ju referuar ligjit nr.53/2019 dhe Statutit të ASH, nuk rezulton që të ketë parashikime në lidhje me detyrimin e ASH për hartimin e ndonjë dokumenti të posaçëm që sipas ankuesit emërtohet “Instrumenti i Vlerësimit”. Ligji nr.53/2019, ka deleguar rregullimin e procesit të konkurimit, vlerësimit dhe përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Asamblesë së ASH, tek Statuti i

ASH. Procedurat e vlerësimit të kandidatëve, bëhen sipas Aneksit 2, të Statutit “*Kriteret Specifike dhe procedurat e vlerësimit të tyre për zgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Akademisë*”.

Referuar shkresës nr.86 prot datë 08.02.2023, nëpërmjet të cilës ASH i ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion të paraqitur nga ankuesi pas përfundimit të procesit të konkurimit, ASH sqaron se: “3. Fleta e votimit, formati, standardi, është pjesë e Aneksit nr.3 të Statutit, Procedurat e votimit dhe të përcaktimit të fituesit për zgjedhjen e kryetarit, të anëtarëve të Kryesisë dhe anëtarëve të Akademisë, për çdo rast votimi në Asamble. Fleta e votimit është publike (f.36-38 e Statutit). Sekretimi i saj, pajisja me elementë të sigurisë, bëhet përmes vulës së institucionit. Komisioni i votimit vërteton sigurinë e saj”.

Nga shqyrtimi i fletëve të votimit të përdorura në votimin e datës 06.02.2023, të depozituara nga ankuesi, konstatohet se, formati dhe standardi është sipas Aneksit 3, të Statutit. Ndërsa, për sa i përket elementëve të tjera të sigurisë së fletës së votimit, Statuti i ASH nuk ka parashikime. Në mungesë të një rregullimi konkret, referuar shkresës së mësipërme, rezulton se, sekretimi i fletës së votimit dhe pajisja me elementë të sigurisë, bëhet përmes vulës së institucionit, dhe se është Komisioni i votimit vërteton sigurinë e saj.

Rezulton se, strukturimi i fletës së votimit është bërë sipas Aneksit 3, të Statutit të ASH, ku parashikohet shprehimisht se, në rastin me dy kandidatë, votohet me një fletë votimi që përmban dy raunde. Në këto kushte, pavarësisht pretendimit të ngritur nga ana e ankuesit për paqartësinë e përmbajtjes së fletës së votimit dhe strukturimit në një fletë dhe në një raund, të dy të ashtuquajturve raunde votimi, rezulton se, një gjë e tillë është bërë konform parashikimeve të Statutit të ASH dhe ka qenë njësoj e aplikueshme për të gjithë kandidatët në konkurim.

Konstatohet se, Statuti i ASH nuk parashikon dëgjimin e kandidatëve gjatë mbledhjes së Asamblesë së ASH, por paraqitja e kandidatëve bëhet nga ana e Kryetarit të ASH. Konstatohet nga aktet e administruara se, prezantimi në mbledhjen e Asamblesë së ASH i kandidatëve si për ankuesin ashtu dhe për kandidatët e tjerë është bërë nga Kryetari i ASH. Të gjithë kandidatët, sikurse ankuesi janë prezantuar nëpërmjet profileve shkencore dhe nuk është bërë paraqitja e detajuar e CV-ve të tyre.

Ankuesi pretendon se, edhe pse nuk ka ndalesë ligjore për të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së ASH, ai nuk është thirrur të jetë prezent, ndërkohë që disa kandidatë të tjerë si A.H, A.B dhe V.M, janë thirrur, kanë marrë pjesë në mbledhje në pjesën e parë dhe kanë qenë të pranishëm në mjediset e institucionit në pjesën e dytë, atë të votimit, fakt ky që sipas ankuesit rezulton i provuar duke hapur faqen zyrtare të *facebook*-ut të Akademisë. Referuar shkresës nr.86 prot., datë 08.02.2023, nëpërmjet të cilës ASH i ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion të paraqitur nga ankuesi pas përfundimit të procesit të konkurimit, ASH është shprehur se: “*Asnjë kandidat nuk mori e nuk ka marrë pjesë në procesin e zgjedhjes nga Asambleja. Kandidatët ftohen e marrin pjesë në mbledhjen e seksioneve, aty anëtarët njihen edhe drejtëpërdrejt me veprimtarinë e kandidatëve përveç dokumentacionit*”.

Në kuadër të zhvillimit të procedurës, nuk rezulton që ndonjë nga kandidatët e përfshirë në konkurim të jenë ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së ASH të zhvilluar në datën 06.02.2023. Prezenca e disa kandidatëve gjatë pjesës së parë të mbledhjes së Asamblesë apo prezenca e tyre në mjediset e institucionit në pjesën e dytë, sikurse pretendohet nga ankuesi, nuk provon se ata janë thirrur për të marrë pjesë nga ASH, pasi prezenca mund të jetë rezultat i pjesmarrjes vullnetare e këtyre kandidatëve. Ankuesi nuk shpjegon nëse është paraqitur për të marrë pjesë në mbledhje dhe nuk është lejuar.

Ankuesi parashtroi se, askush nuk mund të sjellë prova mbi botën e brendshme, paramendimet e faktorëve vendimarrës, për të provuar diskriminimin me kontekst kulturor dhe krahinor. Por rezultatet fundore, analizat statistikore të anëtarësisë janë mjaftueshëm për të shkuar në këtë përfundim. Shqyrtimi i anëtarësisë, pranimeve të reja, fakti që pothuajse askush nga Shkodra dhe Komuniteti katolik e ka të pamundur të jetë i lirë për të konkuruar dhe pranuar, mjafton për të kuptuar se ka një përcmim goditës dhe asgjësues. Po ashtu, parregullsitë, shkelja e ligjeve mbi anëtarësimin në departamentet e institucioneve publike, shkelja e hapur e Statutit të ASH, veprimet e parregullta dhe të mangëta që sjellin rezultate dekapituese për njerëzit e punës, akademikët kandidatë, në fund të fundit, nuk janë gjë tjetër, veçse rruga nga ku kalohet për të ligjëruar një proces diskriminues nga ana e autoriteteve që kontrollojnë gjithçka.

Sipas ankuesit, shumatorja e shkeljeve të Statutit, ligjit që garanton barazitë e të drejtave të qytetarëve, parregullsitë procedurale, mungesa e garancive në sigurimin e të dhënave dhe dokumentave, zbrazëtitë në vlerësimin akademik, mendjehetësia e administrimit të të gjithë procesit të datave 19.12.2022 dhe 06.02.2023, dhe klima antidemokratike dhe antiligjore e krijuar ndaj akademikëve me rezultate dhe teza të ndryshme shkencore nga historia me prejardhje nga diktatura, përbën në fund të fundit një hapësirë abuzimesh me lirinë dhe të drejtat e njeriut, mundësi ndërhyrjesh dhe pilotimesh.

Ankuesi pretendon se, injorimi nga ana e drejtuesve të Akademisë së recensimit të punës së kandidatëve, mbajtja e tyre krejtësisht të painformuar zyrtarisht mbi procedurën, mos thirrja e tyre për të prezantuar veten në mbledhjen e datës 6.02.2023, të krijon bindjen se, djegia e vendit në fushën e historisë, ku procesi u mbyll pa asnjë fitues, ishte e paracaktuar për t'u mbajtur hapur për persona të tjerë.

Bazuar në sa më sipër, konstatohet se, ka një mungesë të parashikimeve konkrete në lidhje me procesin e votimit dhe mënyrën e administrimit të materialit zgjedhor dhe dokumentimit të fazave të këtij procesi. Konstatime të cilat rezultojnë në kundërshtim me parashikimet konkrete të bërë nga Statuti i ASH, konsistojnë në: - mosrespektimin e detyrimit për të bërë me dijë Asamblenë e ASH, 1 (një) javë përpara mbledhjes apo mbledhjes së zhvilluar në SSHSHA, konform nenit 26, pika 6, të Statutit të ASH: - mosrespektimin e kuorumit të kërkuar sipas nenit 43, pika 3, të Statutit, për pjesmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve në mbledhjen e Komisionit të Historisë dhe Arkeologjisë.

Në bazë të të dhënave të administruara nga ana e Komisionerit, konkretisht CV-ve të kandidatëve që kanë marrë pjesë në konkurim, të administruara nga faqet zyrtare të institucioneve ku kandidatët janë të punësuar apo faqes zyrtare të ASH, dokumentacion i cili është administruar në dosje, rezulton se:

Në fushën e arkeologjisë, kandidatët në konkurim kanë qenë 2 (dy), nga të cilët, kandidati i shpallur fitues A.B rezulton me vendlindje Grevë, Peshkopi, ndërsa kandidati L.P, i cili nuk ka rezultuar fitues, rezulton të ketë vendlindjen Kukës. *Në fushën e historisë*, ku ka konkuruar ankuesi dhe ku konkurimi është mbyllur pa një kandidat fitues, rezulton se, ankuesi ka si vendlindje Tiranë, kurse kandidati tjetër H.K, rezulton me vendlindje Dukaj, Tepelenë. *Në fushën e zooveterinarisë*, ku kandidate e vetme ka qenë A.K, rezulton se vendlindja e saj është Tiranë. *Në fushën e gjuhësisë*, ku kandidat i vetëm ka qenë V.M, rezulton se vendlindja e tij është Tepelenë.

Bazuar në të dhënat e siguruar si më sipër, Komisioneri mori shqyrtim edhe vendlindjet e deklaruara nëpërmjet CV-ve të publikuara në faqen zyrtare të internetit të ASH, të anëtarëve të Asamblesë së ASH¹², nga ku rezultoi se:

Pas pranimit të 3 (tre) anëtarëve të rinj që rezultuan fitues nga votimi i datës 06.02.2023, në total Asambleja e ASH ka në përbërje 55 anëtarë, nga të cilët: 8 (tetë) anëtarë kanë të deklaruar në CV, vendlindjen Vlorë; 5 (pesë) anëtarë kanë të deklaruar në CV vendlindjen Sarandë; 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarë kanë të deklaruar në CV vendlindjen Tiranë; 1 (një) anëtar ka të deklaruar në CV vendlindjen Tropojë; 5 (pesë) anëtarë kanë të deklaruar në CV vendlindjen Shkodër; 1 (një) anëtar ka të deklaruar në CV vendlindjen Peshkopi; 1 (një) anëtar anëtar ka të deklaruar në CV vendlindjen Gjirokastrë; 3 (tre) anëtarë kanë të deklaruar në CV vendlindjen Korçë; 1 (një) anëtar ka të deklaruar në CV vendlindjen Elbasan; 1 (një) anëtarë ka të deklaruar në CV vendlindjen Tepelenë; 1 (një) anëtarë ka të deklaruar në CV vendlindjen Dibër; 1 (një) anëtarë ka të deklaruar në CV vendlindjen Skrapar; 1 (një) anëtarë ka të deklaruar në CV vendlindjen Fier; 1 (një) anëtarë ka të deklaruar në CV vendlindjen Mirditë; 1 (një) anëtarë ka të deklaruar në CV vendlindjen Përmet; 1 (një) anëtarë ka të deklaruar në CV vendlindjen Durrës. Për 3 (tre) anëtarë të Asamblesë së ASH, nga të dhënat e publikuara, nuk është e mundur që të identifikohet vendlindja.

Anëtarët e Asamblesë së ASH rezultojnë të jenë bërë pjesë e ASH në periudha të ndryshme kohore, duke datuar që prej vitit 1973, në rastin e Akademik Emeritus L.O, e në vijim për anëtarët e tjerë të Asamblesë së ASH, të anëtarësuar më vonë. Nuk ka asnjë informacion apo të dhënë për të gjykuar dhe vlerësuar në lidhje me përkatësinë ndaj ndonjë komuniteti të caktuar fetar të anëtarëve të Asamblesë së ASH. Përbërja e Asamblesë së ASH është produkt i një periudhe të gjatë kohore dhe i faktorëve për të cilët nuk ka informacion. Në këto kushte dhe me të dhënat në dispozicion, është objektivisht e pamundur për të gjykuar dhe vlerësuar në lidhje me pretendimet e ankuesit se, pothuajse askush nga Shkodra dhe Komuniteti katolik apo nga Gegnia, e ka të pamundur të jetë i lirë për të konkuruar dhe për t'u pranuar. Gjithashtu, nga të dhënat e

¹² <https://akad.gov.al/ash/home/asambleja/anetar/anetar-asamble>

administruara rezulton se ka përfaqësues nga Shkodra, ndërsa kandidati fitues në fushën e arkeologjisë është nga Peshkopia.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, nuk rezultoi që të ketë patur kontestime apo pretendime nga anëtarët e Asamblesë së ASH, në lidhje me tjetërsimin e votës së tyre.

Komisioneri dëshiron të tërheqë vëmendjen, në lidhje me mos sjelljen e të gjithë informacionit të kërkuar gjatë shqyrtimit të çështjes nga ana e ASH, një sjellje kjo që vjen ndesh me nenin 32, pika 2, të LMD ku parashikohet : *“2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.”*

Nga tërësia e procedurës së ndjekur gjatë procesit të zgjedhjes së anëtarëve të rinj në Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Komisioneri konstaton se, rregullat statutores, nuk kanë parashikime procedurale për të gjitha fazat e konkurimit apo në disa raste këto parashikime janë të paqarta. Mungesa e procedurave të mirëpërcaktuara dhe paqartësia e rregullimeve ekzistuese, gjeneron një diskrecion të madh për autoritetin. Në këto kushte, Komisioneri dëshiron të evidentojë, nevojën për të patur një qartësi procedurale në Statut, për të shmangur dyshimet që mund të lindin në kuadër të ushtrimit të diskrecionit nga ana e autoritetit.

Bazuar në sa mësipër, Komisioneri konstaton se, mungesa e rregullimeve të posaçme në lidhje me procesin e votimit, por edhe mosrespektimi i dispozitave përkatëse të Statutit të ASH të konstatuara, kanë gjetur njësoj zbatim për të gjithë konkurentët që kanë marrë pjesë në konkurim për anëtar të Asamblesë së ASH. Procedurat e ndjekura gjatë konkurimit, kanë qenë të njëjta si për ankuesin ashtu dhe të gjithë kandidatët në të gjitha fushat e shkencës të përfshira në konkurim, përfshirë fushën e historisë, ku ka kandiduar ankuesi.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit, nuk konstatohet se ka një ndryshim në trajtim të ankuesit krahasimisht me kandidatët e tjerë që kanë marrë pjesë në konkurim, si në fushën e historisë ku ka kandiduar ankuesi, ashtu edhe me kandidatët e fushave të tjera, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi. Procedurat e ndjekura kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatët dhe nuk rezultoi që këto procedura të njëjta në dukje, të kenë vendosur në kushte më pak të favorshme ankuesin për shkaqet e pretenduara prej tij.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Parregullsitë e konstatuara apo mungesa e rregullimeve të posaçme në lidhje me procesin e votimit edhe nëse potencialisht do të cenonin procedurën e konkurimit të kundërshtuar nga ankuesi, nuk paraqesin aspekte që kanë të bëjnë me diferencë në trajtim të ankuesit krahasuar me kandidatët e tjerë.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi R.G nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Akademisë së Shkencave, në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë. Në mungesë të trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 32 e 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit z.R.G, për shkaqet e pretenduara prej tij, nga ana e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Konceptoi: K.Keta, Inspektore DHA
Rishikoi: L.Jani, Inspektore DHA
Konfirmoi: V.Bushati, Drejtore DHA
Datë: 25.08.2023